

KOMUNISTËT RUANIN ROLIN HEGJEMON

Xhafer Durmishi-Skenderi

**Relacioni i LËVIZJES së JUSUF GËRVALLËS dhe ORGANIZATËS MARKSISTE
LENINISTE TË KOSOVËS (OMLK) gjatë periudhës prill-tetor të vitit 1981**

1. Komunistët RUANIN rolin hegjemon
2. Tash së fundi jam në kontakt
2. Ka një mirëkuptim midis nesh
3. Ndërprerja e daljes së Lajmëtarit të lirisë
4. Menjëherë kishin shtruar çështjen e bashkimit
5. Bashkëpunim apo ndihmë e njëanshme për OMLK-në
6. I kam dhënë vetes të drejtë
7. Dy degë të të njëjtit trung
8. Ai ka një propozim konkret
9. Sugjerime nga instanca të rëndësishme
10. Titulli duhet ndërruar
11. Ka një keqkuptim mes meje dhe teje
12. Ambasada turke nuk më jep kurrsesi vizë
13. Të falem nderit për autorizimet që më jep në shumë drejtime
14. AUTORIZIMI QË MË KE DHËNË LIDHUR ME BASHKIMIN E DY ORGANIZATAVE
TONA
15. UNË SHOH NJË DISPONIM TË KADRI ZEKËS DHE SHOKËVE TË TIJ QË KJO PUNË TË
MOS BËHET PËRMES MEJE
16. Nuk i kanë shtruar hollësisht e me shkrim ato që duan të dinë e që kërkojnë
17. Njeri i përshtatshëm, bie fjala Shpendi a Bardhi
18. S'DUHET TË KEMI TË BËJMË FARE ME TË HUAJTË
19. NË TAKIMIN E MBRËMSHËM, TË 30 KORRIKUT 1981
20. Detyra që Jusuf Gërvalla ia ngarkon Haxhi Berishës
21. Kur lindi Partia
22. Do t'ia bëjmë edhe ne si Lech Walesa
23. Ndoshta pikërisht nga radhët e tyre
24. Atje ku duket se ka pasur pasivitet ose harresë
25. Pse ke ardhur?
26. A vlejné këto fjalë edhe për mua?
27. As rastësisht nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur
28. Janë si buka prej një brumi
29. Iu kemi kundërvu ideologjisë komuniste
30. Patentimi i formulës sekrete të lirisë dhe përralla e Crvenkapës

1. Komunistët RUANIN rolin hegjemon

Faridin Tafallari: *“Me organizatën Marksiste Leniniste të Kosovës (OMLK), që e kishte qendrën e vetë në Zvicër u vu në lidhje edhe Hysen Gegaj. Ky na tregoi se ishte takuar me përfaqësuesit e kësaj organizate. Hyseni foli shumë mire për ta. Por shtoi se për t'u bashkuar pranonin vetëm me kushtin që të udhëhiqnin ata.”* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 28)

Vlerësimet e mëposhtme të Hasan Malës e Xhafer Shatrit janë për librin "Terror-Dhimbje-Qëndresë të Faridin Tafallarit.

Hasan Mala: "Nga zemra të uroj shumë sinqerisht dhe sukses, se është shkruar ashtu si është, si ka qenë. Të lumtë, të lumtë se aty është e vërteta dhe vetëm e vërteta." (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f.382)

dhe

Xhafer Shatri: "Libri është një realitet dhe i paanshëm. Ky libër është si një lis i natyrshëm...Andaj, të lumtë dhe të uroj nga zemra suksese që iu kushtove këtij libri madhor të kohës...". (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f.382)

Mehmet Hajrizi: "Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të **RUANTE ROLIN HEGJEMON.**" (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

Brat Berat Luzha: "Faktikisht, ne jemi **vetëquajtur** marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.

...Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik.

...Përmes ngjyrimin ideologjik, kemi tentuar t'i kundërvihemi ideologjisë komuniste titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 220)

Kështu pra OMLK e vetëquajtur marksiste-leniniste, me ngjyrimin e vetë ideologjik, me komunizmin e vetë të rrejshëm e ka luftuar komunizmin e vërtetë titist. Që në fillim duket qartë se cili është sukcesi i OMLK-së që me komunizmin e vetë të rrejshëm e me ngjyrimin, të cilit i ka dalë boja, ta RUAN rolin hegjemon në raport me Jusuf Gërvallën dhe Lëvizjen e tij.

2. Tash së fundi jam në kontakt

Jusuf Gërvalla: "Tash së fundi jam në kontakt edhe me **një shok** të grupit të Marksistë-leninistëve të Kosovës, të tubuar rreth organit të tyre "Liria". Personalisht, për organin e tyre kam mendim shumë të mirë, po edhe shoku me të cilin kam kontaktuar duket shumë i ngritur dhe i pjekur." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 259)

Për relacionin e Jusuf Gërvallës me Kadri Zekën kam shkruar pak në artikullin "Organizatrat politike shqiptare në Evropë 1979-1985". Këtu do të bazohem në çdo fjalë që e kam thënë më 1992, por situata e kërkon që ky shtjellim të zgjerohet ashtu siç e meriton. Këtë çështje tani është edhe më lehtë ta studiojmë pasi gati të gjitha letrat e Jusufit, si anëtarë i LNÇKVSHJ janë bërë publike.

Që ta kemi një tablo sa më të plotë do të kthehem pak në kohë në fillimet e njohjes së Jusufit me Kadriun, njohje e cila është bërë në kohën kur Jusufi me Ibrahim Kelmendin nuk ka kurrfarë kontakti. Letra e parë e Jusufit dërguar Sabri Novosellës më 14 prill 1981, është dokumenti i parë që Jusufi me shokë të Lëvizjes së vet flet për OMLK-në.


3. Ka një mirëkuptim midis nesh

Jusuf Gërvalla: *"Ka një mirëkuptim midis nesh dhe kemi rënë në ujdë që t'i bashkërenditim veprimet. Lidhur me këtë, për fillim, kemi zënë të organizojmë një varg demonstratash, nëpër qendra të ndryshme evropiane, që kanë për qëllim të bëhen përpjekje e zëshme e ngjarjeve aktuale në Kosovën tonë trime."* (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 259-260)

Këtu flet Jusufi për **mirëkuptim** me Kadri Zekën. Prej njoftimit e deri në fund të jetës, Jusufi kontaktet e veta me OMLK-së i ka vetëm përmes Kadri Zekës. Ky kontakt i Jusufit në bazë të karakterit të tij njerëzor dhe organizativ i mjafton. Se a ka pasur apo nuk ka pasur Kadriu asnjë anëtarë të organizuar jashtë, apo 300 anëtarë e 300 kandidatë kjo punë Jusufit nuk i ka interesua.

4. Ndërprerja e daljes së *Lajmëtarit të lirisë*

Kadri Rexha. *"Jusuf Gërvalla shihte në horizont bashkimin e domosdoshëm të forcave të organizuara patriotike dhe revolucionare, që vinte si nevojë e frontit të luftës së organizuar në kushte të reja, si nevojë e lëvizjes së masave të gjëra, si nevojë e rezistencës dhe e veprimit aktiv të popullit tonë. Prandaj duke e ndërprerë botimin e revistës (*Lajmëtarit të lirisë* - shën. i Xh. D.) Jusuf Gërvalla në këtë drejtim po i jepte shenjat e para të bashkimit."* (Fati i luleve, Prishtinë 1993, faqe 199)



Se Jusufi, pas njohjes me Kadri Zekën dhe revistën "*Liria*" vendosë për ndërprerjen e *Lajmëtarit të lirisë* është e vërtetë, dhe motivi i Jusufit është pikërisht ashtu siç e ka parashtrua Kadri Rexha.

Mehmet Hajrizi: *"Jusuf Gërvalla, pasi filloi bashkëpunimin me 'Lirinë' e pushoi botimin e 'Lajmëtarit të lirisë'. Po kështu veproi edhe Fronti i Kuq me 'Bashkimin'. Në revistën e tij 'Lajmëtarit të lirisë', Jusuf Gërvalla shkruante: 'Këto ditë na ra në dorë numri i parë i revistës ilegale kosovare 'Liria, organ i marksistë-leninistëve të Kosovës. Duke u nisur nga përmbajtja e saj, nga qëndrimi marksist-leninist në të shqyrtuar të temave të qëlluara vitale, si dhe nga gjuha e stili përkatës, shumë i pëlqyeshëm, si dhe nga entuziazmi për punën e ndershme të autorëve të kësaj reviste, të gjithë lexuesve tanë u rekomandojmë ta*

gjejnë e ta lexojnë me kujdes 'Lirinë'." (Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, faqe 124)

Jusuf Gërvalla: *"Këto ditë na ra në dorë numri i parë i revistës ilegale kosovare 'Liria', organ i marksistë-leninistëve të Kosovës. Duke u nisur nga përmbajtja e saj, nga qëndrimi marksist-leninist në të shqyrtuar të temave të qëlluara vitale, si dhe nga gjuha e stili përkatës, shumë i pëlqyeshëm, si dhe nga entuziazmi për punën e ndershme të kësaj reviste, të gjithë lexuesve tanë u rekomandojmë ta gjejnë e ta lexojnë me kujdes 'Lirinë'."*

Po këtë porosi kemi edhe kur është fjala për revistën 'Bashkimi', organ i Frontit të Kuq, me të cilin besojmë, lexuesit tanë të ndershëm kanë pasur rastin të njihen edhe më herët." (Lajmëtari i lirisë, nr.2, tetor - nëntor 1980, faqe 14)

Shkaqet e ndërprerjes së "*Bashkimit*" të Frontit të Kuq dhe rolin e Sadik Blakajt i kam trajtuar në tërësi në shkrimin "Kështu e pata kuptuar" (www.pashtriku.org). Dalja e gazetës *Bashkimi* nuk ka qenë e mrvarrur nga Fronti i Kuq por nga Jusuf Gërvalla. Jusufi e ndërprente angazhimin në gazetën *Bashkimi* për hir të Hysen Gegës dhe jo për hir të revistës *Liria* apo të Kadri Zekës e Mehmet Hajrizit.

Sa i përket *Lajmëtarit të lirisë*, ashtu siç e kanë paraqitur shokët e Kadri Zekës e sidomos Mehmet Hajrizi nuk është. Sipas krekosjeve të disa komunistave të modës, del se përmbajtja e artikujve të "*Lirisë*" të shkruar nga komunistat e modës, me ngjyrën e ngjyrimet e modës, Jusufit ia kanë qitë vehten prej huji dhe sipas kësaj pikërisht pse Jusufit i paska dal vehtja prej huji, në atë farë gjendje depressioni vendosë me e ndërpre *Lajmëtarin e lirisë*. Numri i parë i *Lirisë* ka dal në tetor 1980, dy muaj pas numrit të *Lajmëtarit të lirisë*. Profecia e *Lajmëtarit* për daljen e *Lirisë*, pra është realizue brenda dy muajsh. Ajo çka është tepër e çuditshme në këtë mes është se si nuk doli deri më sot askush nga anëtarët apo kandidatët e flaktë të *Lirisë*, për ta akuzuar Jusufin se ua ka përvetësue emrin e *Lirisë* d.m.th. emrin "*Liria*" e ka përdorë si pjesë në emërtimin e plotë "*Lajmëtari i lirisë*" nga gazeta e tyre që ka dalë dy muaj më vonë. Kjo për mua është anomali dhe çështja më e pakuptueshme gjer më sot.

Siç e kam thënë në një rast tjetër, gjatë shkrimit të numrit të fundit të *Bashkimit* (dhjetor 1980), Jusufi as që e ka pasë ndërmend ndërprerjen e *Bashkimit*. Ky fakt tregon se përkundër të gjithave, përkundër krekosjeve të mëdha prej të cilave ekziston rreziku me i marrë mësysh vehtes, Jusufit nuk i ka dalë vehtja prej hujit edhe pasi i ka lexuar artikujt e modës të komunistave të modës në revistën *Liria*. Megjithatë fakti është fakt, revista *Liria* dhe serioziteti i dukur në atë kohë, që kanë ardhë prej anëtarëve të tubuar rreth *Lirisë*, ka ndikim të madh në ndërprerjen e *Lajmëtarit të lirisë*. Këtu vlen të përsëritet se ndërprerja e *Bashkimit* është sqaruar tani tërësisht se është e një karakteri krejt tjetër. Përveç revistës *Liria*, ndikimi vendimtarë për ndërprerjen e *Lajmëtarit të lirisë* ka ardhur nga ngjarjet e Kosovës të filluara më 11 mars 1981. Ndërprerja e *Lajmëtarit* dhe koncentrimi i tërësishëm i Jusufit në botimin e *Lirisë*, si gjest i bashkimit të forcave për goditje sa më të koncentruara, është përshëndetja e përgjigja më domethënëse që Jusufi ia dërgon Kosovës.

4. Menjëherë kishin shtruar çështjen e bashkimit

Një pasqyrë krejt tjetër false na e paraqet Sabri Novosella në shkrimin "Si e themeluan Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi - LRSNJ", me rastin e dhjetëvjetorit të themelimit të LRSNJ – mars 1992.

Sabri Novosella: "*Në Evropë kishin marrë kontakt Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka dhe menjëherë kishin shtruar çështjen e bashkimit të organizatave ekzistuese. Për këtë Jusufi vazhdimisht e njoftonte degën e LNÇKVSHJ-së në Turqi dhe Metush Krasniqin, Kryetarin e Lëvizjes në Kosovë.*" (Zëri, 28 mars - 4 prill 1992)

Jusufi i shkruan Sabri Novosellës më 14 prill 1981, se "***Tash së fundi jam në kontakt edhe me një shok të grupit të Marksistë-leninistëve të Kosovës, të tubuar rreth organit të tyre "Liria".***"

Kjo letra 14 prillit 1981 është shumë informative ashtu siç është edhe çdo gërmë e Jusufit e hedhur në letër. Pika e parë kjo tregon se kontakt me shkrim Jusufi merr me Sabri Novosellën pikërisht 16 muaj pas ndarjes së tyre më 14 dhjetor 1979 në Prishtinë.

Sabri Maxhuni - Novosella: "Ragip Hoxha ishte kryekonsull i Shqipërisë në Stamboll. Unë i prita shumë mirë. Ragipi kërkoi që të dalim dhe të bisedojnë më lirshëm. Dolëm. Ragipi më tregoi se ishte në dijeni për çdo gjë për mua, për rrugën time nëpër Shqipëri

dhe porosinë që e kishte për të kontaktuar me mua. E falënderova për vizitën dhe kërkova nga Ragipi, nëse e kishte marrë adresën e Jusuf Gërvallës nga Gjermania, pasi që Ajat Haxhiu më kishte thënë "që mos të dërgoja njerëz te Jusufi, sepse Jusufi është vendosur në një vend të sigurt dhe se lidhjen me Jusufin do ta siguronte përmes lidhjeve tona." (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010, faqe 138)

Pika e dytë, kjo na tregon përafërsisht se kontakti me Kadri Zekën është vendosur **tash së fundi** (d.m.th. pas 11 marsit dhe si pasojë direkte e ngjarjeve në Prishtinë nga 11 marsi e më tutje dhe jo si pasojë e daljes së revistës *Lajmëtari i lirisë* apo *Liria*, siç kam menduar unë më 1992, nga shkakku se më 1992 nuk i kam pasur në dorë të gjitha faktet e Jusufit sikur më 2010).

Fjalja ime nga viti 1992

Xhafer Durmishi: *"Në tetor 1980, dy muaj pas numrit të parë të "Lajmëtarit të lirisë" filloi dalja e revistës "Liria", organ i Marksistë-Leninistëve të Kosovës, që pati si rrjedhim edhe njohjen e Kadri Zekës me Jusuf Gërvallën."* (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f. 327)

- në dritën e letrës së Jusufit del e gabuar. Unë kam menduar se Jusufi me Kadriun janë takuar shumë më heret se sa takimi e njohja e tyre në të vërtetë. Jo revistat por është 11 marsi ai që ka ndikua në njohjen e Jusufit me Kadri Zekën.

Jusufi me ndihmën e Bardhit del në skenë menjëherë qysh në janar 1980.

Letra e Jusufit e 14 prillit 1981 vërteton kohën e rivendosjes së kontaktit të Jusufit me Sabri Novosellën, pastaj kohën shumë të përafërt të vendosjes së kontaktit me Kadri Zekën. Kjo letër vërteton edhe kohën e sidomos mënyrën e vendosjes së kontaktit të Jusufit me Ibrahim Kelmendin. Ja se çka thuhet në te:

Jusuf Gërvalla: *"Në fillim të qëndrimit tim këtu, më ofroi bashkëpunim me gazetën "Bashkimi", organ i Frontit të Kuq Popullor, njëri nga bashkëpunëtorët e saj. Meqë gazeta edhe më parë shkonte në popull, madje në një gjendje të keqe, unë e pashë të udhës dhe të lejueshme dhe bashkëpunova me të në disa numra (të cilët po t'i dërgoj menjëherë – te artikujt e shkruar prej meje po e vë nga një shenjë)." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 259)*

Nga 8 faqet e botuara të Ditarit të Jusufit, ku përshkruhen ngjarjet e një muaji, pra nga 14 dhjetori 1979 deri më 14 janar 1980, askund nuk përmendet Ibrahim Kelmendi, çka do të thotë se rreshtat e mëposhtëm janë falsifikime e shpikje të shokut të mirë të Sadik Blakajt:

I. Kelmendi: (Fjalë të atribuara Bardhoshit): *" – Mezi ia doli të arratisëj vëllai, Jusufi. Isha ta ndihmoja për të hyrë ilegalisht në Austri. Ai dëshiron të të takojë sa më parë."* (Atentatet, faqe 9)

I. Kelmendi me fjalitë e mësipërme ka dashtë me thënë se është Jusufi ai që e ka kërkuar atë në radhë të parë dhe jo ai Jusufin. Kush e ka thirrur kend në telefon na del si çështje shumë më e rëndësishme siç do ta shohim në shtjellimet tjera të kësaj teme. Por ai (I. K.) thelbin e fjalisë së lartë e shkatërron dhe prapë se prapë e zbulon dhe e demanton veten duke thënë se është ai që iu ka afruar Jusufit së pari me shpresë se do të pranoj me ia redaktua gazetën.

I. Kelmendi: *" – Jusuf Gërvalla, i thonë. Tani do të më ndihmojë ta përsosë drejtshkrimin e shqipes dhe do të m'i korrigjojë shkrimet për gazetën Bashkimi. Shpresoj se do të pranojë edhe ta redaktojë gazetën."* (Atentatet, f.11)

Në fillim të shkurtit 1980 Jusufi i përvishet punës dhe e ndihmon revistën *Bashkimi*, organ i Frontit të Kuq, pa e ditur dhe pa dyshuar se Fronti i Kuq është emërtuar dhe bashkëthemeluar nga UDB-a. Pas mesit të dhjetorit 1980, për këtë çështje ai ka dyshime aq të forta dhe në mënyrë të njëanshme i ndërprente të gjitha marrëdhëniet me I. Kelmendin.

Pa u largua nga tema, dua të them se Jusufin, përmes Bardhit ka qenë më lehtë me e gjetur sepse Jusufi me gazetën Bashkimi ka dalë në skenë menjëherë. Kadri Zeka ka qenë në Zvicër prej prillit 1978 dhe atij ka mundur t'i interesoi se çka është çështja e revistës Bashkimi dhe puna e Frontit të Kuq. Në sondazhet e tyre Hydajet Hyseni, heret e ka gjetur Ibrahim Kelmendin por jo edhe Jusufin. Arsyeja është tepër e thjeshtë. Ata nuk janë mërzit për Frontin e Kuq pasi kanë qenë të preokupuar me përgatitjen e Frontit të tyre të madh popullor.

Selatin Novosella: "*Duke folur për rrethanat e kohës dhe përpjekjet organizatave të ndryshme të bënin një bashkim veprues, Sabri Novosella, po në këtë numër të gazetës së cituar (Drita, Malmö, nr.10/1997-shën i Xh. D.), shton: "Ne shumë shpejt vumë kontakte të rregullta me Jusuf Gërvallën, i cili tashmë, bashkë me të vëllanë Bardhoshin, dhe të shoqen Suzanën, e kishin formuar Degën e Lëvizjes në Gjermani."* (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 139)

Jusuf Gërvalla: "*Dhe kështu, për caq kohë sa njihemi- e nuk është pak po më se dhjetë muaj-ne të shumtën i kemi rënë kush thumbit e kush patkoit. Mendoj se kjo e ka arsyen e vet objektive. Ti ke njerëzit e tu, me të cilët, sipas mendjes sime, ke vështërsi në realizimin e kontakteve për shkak të largësisë. Kam përshtypjen se, pos kësaj, edhe me ta ke mospajtime dhe sygjerime e urdhrave të tyre s'të fle në hatër tu përmbahesh gjithmonë. Unë nga ana tjetër i kam humbur të gjitha lidhjet me njerëzit e mi dhe për çdo hap që bëj kam stërngarkime, sepse nuk e di në mos bej gjësend, që nuk përputhet me luftën aktuale, që bëjnë ata në vendlindje. Kjo është një tragjedi vetvetiu. Kurse tragjedia tjetër është se edhe unë edhe ti, në këto kushte, ndiejmë pasiguri në një pikë: kë përfaqësojmë..." (Letër I. Kelmendit, nëntor 1980; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 281-283)*

Selatin Novosella: "...Sabri Novosella, po në këtë numër të gazetës së cituar (Drita, Malmö, nr.10/1997-shën i Xh. D.), shton: "*Ne shumë shpejt vumë kontakte të rregullta me Jusuf Gërvallën...*" (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 139)

Bardhosh Gërvalla: "*Herrn Nijazi Saracoglu, Mahmut Pasa Çadesi 82, TR-ISTAMBUL, Türkei*

I dashur Shoku Nijazi, dje, pasi e mora lidhjen telefonike me ju, isha shumë i gëzuar, sepse kanë kaluar më se 15 muaj që po presim ndonjë lajm nga shoku Bashkim Prishtina (Sabri Novosella-shën i Xh. D.), për të cilin ju mund ta dini rastësisht se ku po qëndron. Jusufi, vëllau im para dy ditësh ka shkuar në veri të Gjermanisë tek një nip i yni, kështu që ai nuk mund t'ju shkruan edhe 6 ditë deri sa të kthehet prapë këndeje.

*... Me Shabanin (Shaban Yldrim, Bayerstr. 5, 8000 Munchen - shën i Xh. D.) u njohëm para dy javësh në panairin e artizanatit, ku bënte pjesë edhe Shqipëria. Ai edhe na dha adresën dhe telefonin tuaj. ... Kishte me qenë mirë sikur edhe **Bashkimi** të na shkruajë sa më parë. Në fund po iu përshëndes ju me gjithë familjen dhe dashamirët tuaj. Bardhosh Gërvalla, Habichthöhe 40 D-7101, Untergruppenbach, W. Germany,*

Tel. qyteti Ludwigsburg 7141/26091" (U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari si pjesë e shkrimit "Kur Jusuf Gërvalla shkruante" në www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

Selatin Novosella: "...Sabri Novosella, po në këtë numër të gazetës së cituar (Drita, Malmö, nr.10/1997-shën i Xh. D.), shton: "*Ne shumë shpejt vumë kontakte të rregullta me Jusuf Gërvallën...*" (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 139)

Jusuf Gërvalla: "*Gjëja më e rëndësishme lidhur me "Lajmëtarin" është se, duke qenë krejt i vetmuar, nuk e mora dot guximin ta emëroja atë si organ të LNÇKVSH. Kjo është e vetmja arsye pse në të nuk flitet e brohoritet në emër të Lëvizjes sonë. Mjafton ta përmend faktin se dy materialet e Lëvizjes, që i botova në numrin 3, i lëshova me njëqind druajtje, ngase nuk isha në gjendje të gjykoja vetë dhe të fitoj bindjen e plotë se a bëja mirë apo keq."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Për mua do të ishte sa absurde aq edhe qesharake sikur t'i fajësoja përfaqësuesit e OMLK-së se pse nuk kanë marrë kontakt më heret me Jusufin, kur vetë si me thënë eprori i Jusufit në Organizatë, Sabri Novosella, nuk është në gjendje ta bëjë atë punë për 16 muaj të plotë. Ajo çka deshta të them është se "faji" për marrjen e kontaktit kaq të vonë me Jusufin, qoftë me Sabri Novosellën qoftë me Kadri Zekën nuk është i Jusufit.

Në dritën e këtyre fakteve, shtrembërimet në fjalinë e mëposhtme të Sabri Novosellës na dalin edhe më të qarta:

Sabri Novosella: *"Në Evropë kishin marrë kontakt Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka dhe menjëherë kishin shtruar çështjen e bashkimit të organizatave ekzistuese."*

Ta analizojmë pak këtë fjali të vetme. Në te është përdorë fjala *menjëherë*. Kjo fjala *menjëherë* në këtë rast vepron dhe krijon iluzione në dy drejtime edhe nëse qëllimi i autorit, në rastin më të mirë, ka qenë që ajo të ketë vetëm një kuptim. E vërteta është se:

-Në Evropë, Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka nuk janë takuar *menjëherë*,

-Pas takimit, Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka nuk e kanë shtruar çështjen e bashkimit të organizatave *menjëherë*.

Pas takimit me Jusufin, Kadri Zeka *menjëherë* i kërkon ndihmë Jusufit për përgatitjen e nxjerrjen e *Lirisë*, dhe Jusufi i jep *menjëherë* çdo ndihmë, ashtu siç i kishte ndihmuar Ibrahim Kelmendit gjatë vitit 1980. Dhe në këtë kohë Jusufi *menjëherë* e ndërpre *Lajmëtarin e lirisë*. Si pasojë e ndihmës së pakursyer të Jusufit dhe bujarisë e zemërgjerësisë së tij, Kadri Zeka dhe shokët e tij nuk kanë as arsye më të vogël me qenë të pakënaqur apo me u ngutë e me fillua *menjëherë* bisedime për bashkim.

5. Bashkëpunim apo ndihmë e njëanshme për OMLK-në

Hydajet Hyseni: *"Si rezultat, me propozim të Jusuf Gërvallës, u ndërpre botimi i gazetës Lajmëtarin e lirisë dhe vazhdoi të dalë Liria si botim i përbashkët i OMLK-së dhe LNÇKVSHJ-së", i përgatitur bashkarisht dhe me një teknikë tjetër.*" (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 290)

Puna e Jusufit në revistën *Liria* nuk mund të quhet bashkëpunim i Jusufit me Kadri Zekën e OMLK-në, pasi revista *Liria* nuk ka qenë projekt i përbashkët i Jusufit dhe Kadriut, por vetëm punë, projekt dhe pronë e OMLK-së dhe që Jusufi kurrë nuk ka pretendua e as ushqye vehten me ëndrra që ta ketë hisen e vetë në te. Në këtë kuptim puna e Jusufit duhet të quhet ashtu siç e ka emrin e vërtetë; **ndihmë e njëanshme për OMLK-në**.

Puna e përbashkët për organizimin e demonstratave e Jusufit dhe Kadri Zekës mund të quhet bashkëpunim i tyre, bashkëpunim i OMLK-së me LNÇKVSHJ-në, pasi demonstratat nuk janë bërë për hir të asnjërës organizatë, por hir të luftës së popullit në Kosovë.

Jusuf Gërvalla: *"Me një shok (Kadri Zekën - shën i Xh. D.) të "Lirisë" organizuam në Zvicër dhe në RFGJ katër demonstrata të punëtorëve kosovarë në botën e jashtme, dhe jemi në prag të organizimit të demonstratës së pestë. Duheshin shkrime, trakte dhe fjalime, pastaj, duhej një vrap i madh për tubimin e njerëzve. Demonstrata e parë u mbajt më 11 prill në Bern të Zvicrës, e dyta më 18 prill në Cyrih të Zvicrës, kurse e treta dhe e katërta në Shtutgart e Dyseldorf të RF Gjermane, më 25 prill, përkatësisht më 9 maj."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 261-262)

Se Jusufi nuk ka kurrfarë bashkëpunimi me I. Kelmendin në këtë kohë e në organizimin e demonstratave, është punë që është vërtetuar. Se si kanë bashkëpunuar në këtë periudhë Kadri

Zeka me shokun e të mëvonshëm të organizatës Ibrahim Kelmendin është çështje që nuk më takon mua ta them.

Në letrën e 13 majit 1981, Jusufi i raporton Sabri Novosellës për Grupin e Riza Salihut e për Frontin e Kuq. Për Grupin e Marksistë-leninistëve të Kosovës ai ka konsiderata krejtësisht tjera:

Jusuf Gërvalla: *"I tillë nuk është as në shkrime as në pikëpamje të organizimit grupi i Marksistë-leninistëve të Kosovës, të bashkuar rreth organit të tyre "Liria". Përkundrazi ata, jo vetëm që luftojnë si ne për bashkimin e domosdoshëm me vendin amë, por, sa kam mundur të konkludoj nga kontaktet e mia me njeriun (Kadri Zekën - shën i Xh. D.) e tyre, janë edhe shumë të pjekur dhe organizatorë të zotët."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 265-266)

Kadri Rexha. *"Jusuf Gërvalla shihte në horizont bashkimin e domosdoshëm të forcave të organizuara patriotike dhe revolucionare, që vinte si nevojë e frontit të luftës së organizuar në kushte të reja, si nevojë e lëvizjes së masave të gjëra, si nevojë e rezistencës dhe e veprimit aktiv të popullit tonë. Prandaj duke e ndërprerë botimin e revistës (Lajmëtari i lirisë - shën i Xh. D.) Jusuf Gërvalla në këtë drejtim po i jepte shenjat e para të bashkimit. Kontributi i Jusuf Gërvallës në botimin e revistës "Liria" u shpreh në hartimin e materialeve origjinale, në përpunimin dhe redaktimin e materialeve të ndryshme, në lekturë, në daktilografimin e materialeve, në përgatitjen teknike, në përkujdesjen artistike, në botimin definitiv të revistës si dhe më në fund, në propagandimin dhe shpërndarjen e saj. Nga ky bashkëpunim i frytshëm kanë dalë në dritë nr.3 dhe nr.4-5 i revistës "Liria".* (Fati i Luleve, faqe 199)

Numri i tretë të "Lirisë", doli në maj 1981, nën mbikëqyrjen teknike të Jusufit, i cili e radhiti dhe bëri të gjithë punën grafike e teknike për nxjerrjen e numrit të tretë. Jusufi, si çdo mendimtar serioz dhe me cilësi të lartë vazhdimisht ka shkruar dhe gjithnjë ka pasur një varg artikujsh të gatshëm. Në këtë pikë ai nuk i ka thënë Kadri Zekës se këtë apo atë shkrim e kam për ty, por ia ka treguar Kadriut të gjitha shkrimet e gatshme për momentin, e në mesin e të cilave Kadriu vetë i ka zgjedhë ato që i janë dukur më të mirat. Për numrin 3 të Lirisë, Kadriu prej shkrimeve të Jusufit i ka zgjedhë:

1. Regjistrimi i popullsisë në Kosovë u bë nën hijen e tankeve
2. Kosovë sa hije të ka xhamadani i trimërisë!

Jusufi gjithashtu organizoi dërgimin e këtij numri në Kosovë, duke e angazhuar për këtë punë shokun e vetë të ngushtë Haxhi Berishën nga Prapaqani, i cili ka futur me mijëra ekzemplarë të këtij numri në Kosovën e mbushur me forca të mëdha ushtarake e me atmosferën e orës policore. Për futjen e numrit të 3 të Lirisë në Kosovë ka kontribuar edhe Kadri Zeka. Për kryerjen me sukses të kësaj rruge ai e ka nisë shokun e vetë Qamil Isufin me pasaportë në xhep, kuptohet me pasaportë revizioniste dhe jo pasaportë proletare ashtu siç i këndon Vladimir Majakovski. Tmerrin dhe vuajtjet e udhëtimeve me pasaportë revizioniste vetëm një komunist i vërtet mundet me i përshkrua. Qamil Isufi shkon për ta organizuar pranimin e *Lirisë* në Kosovë.

6. I kam dhënë vetes të drejtë

Jusuf Gërvalla: *"Tani më lejo të dalim te një nga çështjet më të rëndësishme për momentin aktual, pra, te çështja e bashkimit të vërtetë të të gjitha forcave të mbara revolucionare. Unë, kohën e fundit, me qëllim të mirë, i kam dhënë vetes të drejtë të të dekonspiroj ty tek një person, te ai shoku (Kadri Zeka - shën i Xh. D.) i "Lirisë", me të cilin kemi bashkëpunuar që disa kohë. (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 270)*

Nga rreshtat e mësipërm duket përpikmëria e Jusufit. Ai i tregon Kadri Zekës për Novosellën, pasi ritmi i punëve dhe çështjet e bashkimit të vërtetë e kërkojnë këtë. Por ai nuk harron aspak dhe menjëherë e njofton Sabriun se e ka bërë këtë dhe për çfarë qëllimi e ka bërë. Në këtë çështje Jusufi asgjë nuk ia lenë harresës.

7. Dy degë të të njëjtit trung

Jusuf Gërvalla: *"Ai, duke nxjerrë konkludime nga puna e Organizatës së tij dhe nga ajo e LNÇK, sidomos nga organi ynë "Zëri i Kosovës", ka ardhur në këtë përfundim: sipas të gjitha gjasave, edhe LNÇKVSH edhe Marksistë-leninistët e Kosovës janë dy degë të të njëjtit trung. Një patriot revolucionar, i cili prej kohësh qenka në burg (ai thotë se nuk është fjala për Ademin, por për dikë tjetër), qenka përgjegjës për ndërprerjen e kontakteve mes anëtarëve të vjetër të organizatës së hershme me anëtarët e krahit të ri të kësaj organizate. Kështu që, pjesa e vjetër e asaj organizate (të përbashkët) ka ndjekur një rrugë të caktuar dhe sot ka arritur deri te emri Marksistë-leninistët e Kosovës, kurse krahu i ri, duke mos marrë kontakt me kohë me anëtarët e vjetër, qenka zhvilluar në Lëvizjen e sotme Nacionalçlirimtare të Kosovës. Për këto konkludime ai merr për bazë pikërisht organin "Zëri i Kosovës", të cilin Marksistë-leninistët e paskan pasur gjithashtu organ të vetin për një kohë të gjatë (sidomos që nga viti 1974, thotë ai, paskan dalë disa numra të këtij organi). Në rast të tillë, sipas mendimit të tij, bashkimi i organizatave tona jo vetëm që nuk është i vështirë, por është puna më e natyrshme." (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 270-271)*

Hydajet Hyseni: *"Qysh në bisedën e parë që kishte zgjatur gjithë natën deri në mëngjes, ata jo vetëm kishin gjetur te njëri tjetri shokun e ardhshëm të kauzës e idealit, por edhe kishin konstatuar se në të vërtetë organizatat që përfaqësonin ata vepronin mbi bazë të së njëjtës platformë politike, dhe se ishin degë të shkëputura të të njëjtës rrënjë." (Për takimin e parë të Kadri Zekës me Vëllezërit Gërvalla.) ("Therror në themelet e Bashkimit", fejtton në 8 vazhdime në Zëri, 21 shkurt-2 mars 2002, i ribotuar edhe në përmbledhjen e Rasim Selmanajt, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, f. 28)*

Mehmet Hajrizi: *"... por Partia Komuniste në të RUANTE ROLIN HEGJEMON " (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)*

8. Ai ka një propozim konkret

Jusuf Gërvalla: *"Lidhur me këtë, ai (Kadri Zeka - shën i Xh. D.) ka një propozim konkret, të cilin ia kam aprovuar edhe unë, nëse pranon ti: të vijmë së bashku ai e unë te ti dhe ta ndriçojmë po që e mundur këtë çështje. Fitimi, besoj, do të kish qenë i madh. Ai është një shok i mirë dhe mjaft i pjekur. Por, në qoftë se ti ngul këmbë që nuk duhet t'i hymë fare kësaj pune, atëherë ashtu edhe do të bëhet." (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 271)*

9. Sugjerime nga instanca të rëndësishme

Jusuf Gërvalla: "Edhe një çështje tjetër me shumë rëndësi. Po ky shoku (Kadri Zeka - shën i Xh. D.) i "Lirisë", i cili lidhjet me shokët në Kosovë i mban rregullisht, tash së fundi na njofton sesi nga Kosova i paska ardhur porosia që tash e tutje të mos ngulim më këmbë në kërkesën për përfshirjen e tokave shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi brenda republikës së Kosovës, por të kufizohemi vetëm me statusin e republikës për territorin e sotëm të Krahinës Autonome të Kosovës, sepse gjoja, po të paraqitet kështu çështja, paska njëfarë mangësie për realizimin e kësaj kërkesë. Ai (Kadri Zeka - shën i Xh. D.) shton se gjoja sugjerime të tilla u paskan arritur nga instanca të rëndësishme të atdheut. Unë paraqita kundërshtimin tim kategorik. Në mos qentë tradhti e hapët, një lëshim i tillë, thashë unë, atëherë është një politikë e ligë konjunkturale, të cilën vështirë se do të na e falte populli i pezmatuar, sidomos shqiptarët e viseve jashtë Krahinës, që janë në rrezik edhe nga asimilimi i madh." (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 271)

Plani i Partisë Komuniste (PKMLSHJ): "Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 64)

Pse Abdullah Prapashtica është aq shumë i angazhuar në punët e brendshme të LNÇKVSHJ-së, dhe mundohet ta sqaroj **në detaje** (në të cilat therret aq keq) me pocërkën e vet, gjenezën e mbaresës 'Viseve shqiptare në Jugosllavi'.

Abdullahu është i interesuar në këtë pikë sepse po të ishte si thotë ai, rrjedhimi do të ishte: OMLK-ja është marrë vetëm me çështjen e shqiptarëve për atë territor që është quajtur Krahina Socialiste Autonome e Kosovës. Jusuf Gërvalla dhe Lëvizja e tij e kanë bërë të njëjtën gjë. Ushtruesi i profesionit të udbashit, Abdullah Prapashtica është i vetmi që me partinë e tij "komuniste" është brengos e ka luftuar për të gjithë shqiptarët në Jugosllavi.

10. Titulli duhet ndërruar

Jusuf Gërvalla: "Tani prej teje pres përgjigje të prerë për sa vijon:

1) A e aprovon ardhjen time bashkë me atë shokun, lidhur me sqarimin e çështjes së përmendur, apo se lejon.

2) Pas "pëshjtjellimeve" rreth titullit të organit "Zëri i Kosovës", a të duket e udhës që organit tonë të ardhshëm t'i vëmë një titull tjetër? **Unë mendoj se titulli duhet ndërruar.**

3) A duhet të pranojmë edhe ne, sikundër ata të "Lirisë", solucionin e republikës vetëm për territorin e sotëm të Krahinës së Kosovës?

4) A mendon se duhet edhe më tutje, pas këtyre njoftimeve, ta vazhdoj bashkëpunimin me shokun (Kadri Zekën - shën. i Xh. D.) në fjalë, apo të punoj vetëm, duke iu kushtuar kryekëput punëve të LNÇKVSH dhe të organit të saj të ardhshëm?

Të lutem t'i analizoni hollësisht këto çështje me shokë dhe të më përgjigjeni sa më parë që të jetë e mundshme." (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 271)

11. KA NJË KEQKUPTIM MES MEJE DHE TEJE

Jusuf Gërvalla: "Nga përmbajtja dhe toni i letrave të tua, kuptova që ende s'e ke marrë letrën time të fundit, në të cilën të kam njoftuar për punën konkrete që është duke u bërë rreth nxjerrjes së numrit të ardhshëm të „Zërit të Kosovës“.

Ka një keqkuptim mes meje dhe teje. Kur është fjala për titullin „Zëri i Kosovës“, te unë s'ka pasur as nuk ka „hutesë“ as „trullosje“. E kam në dorë Statutin e LNÇKVSH, ku shkruan qartë se ai është organ i Lëvizjes sonë. Por, kam pasur në dorë edhe disa trakte të të ashtuquajturit Grupi komunist „Zëri i Kosovës“ dhe më kanë dalë kokëçarje pikërisht me udhëheqësin e këtij grupi dhe pikërisht lidhur me këtë titull. Prandaj kam supozuar se mund të ketë hutesë të lexuesi. Vetëm kaq." (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

12. AMBASADA TURKE NUK MË JEP KURRSESI VIZË

Jusuf Gërvalla: "Më lejo tani të informoj për disa çështje tash për tash të rëndësishme.

Lidhur me takimin tonë doli një pengesë tash për tash e pakapërcyeshme: ambasada turke nuk më jep kurrsesi vizë hyrjeje në Turqi. Me gjasë nuk i japin as atij shokut tjetër, se edhe ai e ka punën si unë. Ne do të provojmë ndonjë lloj intervenimi, por sa duket është e kotë. Prandaj, nga ju andej presim ndonjë propozim se si dhe përmes kujt të organizohet ndonjë kontakt, që do të shpiente kah bashkimi." (Letër Sabri Novosellës, 21 korrik 1981)

13. TË FALEM NDERIT PËR AUTORIZIMET QË MË JEP NË SHUMË DREJTIME

Jusuf Gërvalla: "Të falem nderit për autorizimet që më jep në shumë drejtme. Kjo më detyron të rritem e të piqem dita me ditë përtej aftësive dhe mundësive të mia. Mendoj se autorizime më të mëdha (por edhe ato me kufij të theksuar) mund të më jepen vetëm sa i përket nxjerrjes së gazetës. Për të tjerat, sidomos për punë organizative, kujtoj se më mungon përvoja, e sidomos takti. Prandaj është e nevojshme të më jepen këshilla të vazhdueshme, fare mos nguro që këshillat të përmbajnë edhe hollësira." (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

14. AUTORIZIMI QË MË KE DHËNË LIDHUR ME BASHKIMIN E DY ORGANIZATAVE TONA

Jusuf Gërvalla: "Kësaj radhe e kam fjalën konkretisht te autorizimi që më ke dhënë për punë me shokun e „Lirisë“, e veçanërisht të bisedohet me të lidhur me bashkimin e dy organizatave tona. Siç e di, përvoja ime në punë të organizuar ishte e shkurtër dhe unë nuk i di ato hollësi për organizatën tonë, lidhur me të cilat kërkon të informohet shoku i „Lirisë“." (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

15. UNË SHOH NJË DISPONIM TË KADRI ZEKËS DHE SHOKËVE TË TIJ QË KJO PUNË TË MOS BËHET PËRMES MEJE

Jusuf Gërvalla: "*Me një fjalë unë shoh një disponim të tij (besoj edhe të shokëve të tij) që kjo punë të mos bëhet përmes meje. Dhe u jap të drejtë.*" (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

16. NUK I KANË SHTRUAR HOLLËSISHT E ME SHKRIM ATO QË DUAN TË DINË E QË KËRKOJNË

Jusuf Gërvalla: "*Nga ana tjetër, ata ende nuk i kanë shtruar hollësisht e me shkrim ato që duan të dinë e që kërkojnë. Mendimi i tyre, për sa e shoh unë, është se do të duhej të takohesh ti, ose ndonjë shok tjetër nga më të rëndësishmit e Lëvizjes në atdhe, me ndonjë shok të njëjtit nivel, po në atdhe, nga ata të „Lirisë“. Kjo më duket edhe mua e drejtë. Dhe ndoshta vetëm në këtë drejtim do të mund të kontribuonim në këtë moment unë dhe ai shoku i „Lirisë“.*" (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

17. NJERI I PËRSHTATSHËM, BIE FJALA SHPENDI A BARDHI

Jusuf Gërvalla: "*Sa për udhëtim deri te ti (se kështu me korrespondencë është e rrezikshme të thuhet hollësitë) do të gjendej ndonjë njeri i përshtatshëm, bie fjala Shpendi a Bardhi.*" (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

18. S'DUHET TË KEMI TË BËJMË FARE ME TË HUAJTË

Jusuf Gërvalla: "*Formimi i një komiteti për Kosovën ishte ide jona dhe e disa miqve gjerman, si kryetari i Shoqatës Gjermani-Shqipëri dhe anëtar i KQ të PK të Gjermanisë, Peter Platzman, pastaj shoku Hans Röm etj. (Për ta duhet të ketë informata të hollësishme Profesori. Sipas mendimit të tyre, në komitet do të bënin pjesë disa personalitete të shquara të jetës politike, shoqërore e artistike në Gjermani (kështu praktikoheshka këtu në raste të tilla), kurse nga pala e shqiptarëve të Kosovës ata ishin të mendimit që në komitet të hyja unë, për dy arsye konkrete: si njeri që do të siguroja materiale për punën e komitetit dhe si person publik në vendin tonë – gazetar dhe poet. Këto bisedime qenë zhvilluar së bashku edhe me shokun e „Lirisë“ dhe ashtu qe vendosur. Por, më vonë atij i erdhi nga shokët porosia se s' duhet të kemi të bëjmë fare me të huajt. Dhe, qe atëherë, si punë e përbashkët çështja e këtij komiteti ra poshtë dhe në këtë drejtim s' u ndërmer gjë tjetër.*" (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

19. NË TAKIMIN E MBRËMSHËM, TË 30 KORRIKUT 1981

Jusuf Gërvalla: "*Në takimin e mbrëmshëm konkludua se, po të jeni ju andaj të mendimit se kjo punë duhet të vazhdojë, atëherë ne do ta vazhdojmë. Mundësitë janë ato që kanë qenë.*"

Edhe çështja e letrave protestuese drejtuar qeverive të ndryshme dhe kombeve të bashkuara ka qenë e planifikuar të bëhej në bashkëpunim me shokët e „Lirisë“. Por, edhe ajo s' dha rezultat deri më tash. Ne do ta bënim edhe vetë, por ngurronim për një arsye – se, me punë të pavarur, prishnim punë në drejtimin e bashkimit të nevojshëm të organizatave tona. Edhe kjo punë mund të vazhdojë, po e patë ju të arsyeshme, por mendoj se, kur të merrni vendime për çështje të tilla, duhet ta mbani parasysh edhe rrethanën e nevojës së madhe të


bashkimit, duke u prirë nga mendimi leninist se me bashkim nënkuptohet bashkimi i mendimeve, i pikëpamjeve dhe i punëve të përafërta a identike të dy a më shumë organizatave. Atje ku duket se ka pasur pasivitet ose harresë të unë, atje kryesisht ka qenë vendimtar ky parim dhe më pak harresa ose pasivizimi." (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

20. DETYRA QË JUSUF GËRVALLA IA NGARKON HAXHI BERISHËS

Jusufi përgatiti teknikisht numrin 4-5 të "Lirisë", që doli në fillim të gushtit 1981. Në këtë kohë jam vetë në Shtutgart dhe ngjarjet i di si pjesëmarrës i drejtpërdrejt. Për këtë numër prej shkrimeve të Jusufit Kadri Zeka zgjodhi artikullin

3. Tradhtarët e vjetër dhe tradhtarët e rinj, dhe poezinë

4. Shqipja bënë edhe pa gjëmë, i mjafton lavdia.



Edhe në këtë rast ai i dha detyrë **Haxhi Berishës** (fotoja anash) nga fshati Prapaqan i komunës së Deçanit, ta marrë përsipër futjen e këtij numri të dyfishtë në Kosovë. Kësaj radhe, prej anës së Kadri Zekës, ndihmës e shok i tij i rrugës u caktua Hasan Mala. Për ndryshim nga Qamil Isufi, Hasan Mala nuk i ndahet Haxhi Berishës gjatë tërë rrugës.

Çështja e bashkimit u aktualizua pas pushimit të demonstratave në mërgim, aty kah fillimi i gushtit, kur numri 4-5 i "Lirisë" doli nga shtypi.

Në faqen e fundit të numrit 4-5 të "Lirisë" për herë të parë përmendet dhe botohet xhirollogaria e OMLK-së dhe vetëm e OMLK-së, me këto shënime: *Hilfe für Kosova, Katharina Asal – Biel-Biene, Konto 25-45475Biel-Biene Schweiz*"

Por në fund të korrikut e gjatë gushtit e shtatorit 1981, çështja e bashkimit të OMLK-së dhe LNÇKVSHJ dukej aq afër, sa Jusufi pa fijen e dilemave pajtohet me shtyp fletëpagesa të shumta të përshtatura për bankat gjermane për të dërguar të holla në këtë xhirollogari në Zvicër. Shumica e këtyre fletëpagesave shpërndahen nga Jusufi në Stuttgart dhe qytete tjera. Po në Stuttgart, shkruhet nga Jusufi një trakt në emër të "Lirisë" për të ndihmuar luftën ekonomikisht dhe për këtë trakt Jusufi e mori një citat të Sami Frashërit, në të cilin thuhej: *"Kush nuk derdh një pikë gjaku për tok të vet, kush nuk jep asnjë qindar për të, ai s'ka të drejtë as të varroset në te."*

Ndihma për Kosovën nga pjesa e rrethit të Shtutgartit - Sindelfingenit për vitin 1981 në xhirollogarinë: *Hilfe für Kosova - Katharina Asal, 25-45475 Biel/Bienne, SCHWEIZ*

Në formë anonime apo që Faridin Tafallari		
nuk ka mund t'i siguroj emrat -----		580 DM
Abdurrahman Sadiku	Dumnicë	100 DM
Avdullah Bobaj	Korishë	50 DM
Azem Berisha	Korbliq	100 DM
Halil Rexha	Korishë	100 DM
Halit Osmani	Dumnicë	50 DM
Islam Rafuna	Gjilan	50 DM
Mejdi Rexha	Korishë	200 DM

Muharrem Rexha	Korishë	100 DM
Nuhi Ibishi	Dërvar	120 DM
Nuhi Kabashi	Polac	500 DM
Nuhi Sylejmani	Llojan	120 DM
Qazim Ramadani	Smirë	100 DM
Rasim Toska	Gjilan	200 DM
Sali Hasani	Dumnicë	50 DM
Sejdullah Osmani	Qirez	100 DM
Shoqërija e Sindelfingenit		400 DM

(Shënim: Kjo listë m'u bë e njohur në janar 2012)

Për një nevojë të bashkimit flitej e bëhej shumë fjalë. Në pritje të një bashkimi u vendos që të mos dilet me “Zërin e Kosovës” si organ i LNÇKVSHJ-së.

Tek pas dështimit të plotë të bisedimeve në Stamboll, në tetor 1981, këto fletëpagesa, nga Jusufi trajtohen pak më ndryshe.

21. Kur lindi Partia

Ekziston një faktor që ka luajtur rëndësi shumë të madhe në ngritjen e temperaturës së bisedimeve apo të paktën zhurmës shurdhuese e çjerrjeve për bashkim e unitet e që nuk e kam lexua se dikush e ka përmend deri më sot. Në verë 1981 në vitin e 40 vjetorit të themelimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë, doli libri me kujtime i Enver Hoxhës me titull "Kur lindi Partia". Ky libër na erdhi në Shtutgart në gusht dhe Jusufi, unë e shokë të afërm e lexuam me vëmendje për të shikuar se çka mund të mësonim e nxirrnim prej tij lidhur me situatat organizative nëpër të cilat vet kalonim.

Krahasonim grupet, dëmin e liderëve të vjetër të infektuar me frymën e vjetër të grupeve, kush mund të jetë Koço Tashkoja, Enveri, Qemal Stafa, Vasili - Vasil Shantoja, Miladin Popoviqi e Dushan Mugosha ynë. Kush rrezikon të bëhet Anastas Lula e Sadik Premtja ynë.

Pamvarësisht diskutimit të detaleve e personazheve, ky libër e përqendroi vëmendjen tonë në diskutimin për formimin e Partisë Komuniste nga organizatat e asaj kohe, pra në mes LNÇKVSHJ dhe OMLK-së. Thelbi i këtyre ideve ishte shtruar nga Jusufi qysh në dhjetor 1980, në programin e tij të shprehur në artikullin "Bashkimi bënë fuqinë".

Në ndërkohë, përkundër ndërprerjes së *Lajmëtarit të lirisë*, e gjesteve të shumta konkrete të Jusufit në favor të bashkimit me OMLK-në, nga Kadri Zeka dhe OMLK-ja nuk kishte pasur asnjë lëvizje të vetme në këtë drejtim. Në këtë situatë Sabri Novosella i kërkon Jusufit që të filloj me përgatitjen e botimit të "Zërit të Kosovës" si organ i LNÇKVSHJ. Jusufi ia fillon punës dhe pothuajse i ka të gjithë artikujt të gatshëm për numrin e parë, qysh në ditët e para të gushtit 1981. Ja se çka i shkruan ai Sabri Novosellës më 20 gusht 1981:

Ibrahim Kelmendi: *"Të le pa tekst kjo frymë e komunikimit. Poeti, gazetari, publicisti, këngëtari JG me rrobaqepësin gjysmanalfabet SN dhe dëgjueshmëria poshtëruese prej skllavi që, vetëm në bashkëveprimtarit të vullnetshme midis të të barabartëve nuk mund të ngjante! Kush duhet t'ia ketë shkruar letrat SN që të fascinohej Jusufi deri në atë shkallë vetëmohuese e vetëpërlujje!? Kjo është çështja!?"* (Gjurmë e fërkemë, libër i shpërnarë përmes internetit në shtator 2016)

Jusuf Gërvalla: "Materialet e numrit të ardhshëm të "Z.K." janë pothuaj të gjitha të gatshme. Për pjesën e tyre më të madhe, unë, **Shpendi** (Xhafer Durmishi-shën im) e **Besniku** (Bardhosh Gërvalla -shën i Xh. D.) jemi të kënaqur. Morëm zemër edhe nga fakti se ju kishin pëlqyer edhe juve ato punime që ua dërguam edhe juve për t'i shikuar. Përveç kësaj, unë personalisht tani jam në pozitë shumë më të lehtë, për shkak të mendimeve, porosive e sugjerimeve nga ana juaj dhe për shkak të një ndihme, sado të vogël në fillim, nga ana e **Shpendit**, e **Besnikut** dhe e **shokut të "Lirisë"**, që këta më dhanë me disa artikuj të mirë. Edhe **Shpendi** edhe **Besniku**, për sa duket kanë afinitet për shkrim, i cili do të rritet bashkë me punën tonë e me ne. Tani pas hartimit të dy artikujve që kanë mbetur pa u kryer, menjëherë po i hyjmë shtypjes së revistës. (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451)



BARDHOSH GËRVALLA-BESNIKU gjitha letrat ku Jusufi diskuton çështje të Lëvizjes së tij Nacionalçlirimtare. Për praninë time në rrethin e Jusufit të shohim si nënshkruhet Nuhi Sylejmani, në vitin 2010, kur fletë për 21 janarin 1982, rreth orës 14.00.

Plani i Partisë Komuniste (PKMLSHJ): "Me Skënder Skënderin (Xhafer Durmishin-shën im) isha takuar **vetëm njëherë** në familjen Gërvalla, **në shtator të vitit 1981, në prezencën e Islam Rafunës**. Pastaj, as nuk e kam parë, por as nuk kam dëgjuar më për të. Nuk e mora vesh se nga erdhi, nga Kosova apo nga ndonjë vend tjetër, ndodhej ilegal në Gjermani, apo kishte ndonjë leje qëndrimi. Në fillim mendova se qëllimi i vizitës së tij ishte ngushëllimi, por pak kohë më vonë, për befasinë time, Suzana ma prezantoi si „zëvendës“ të Jusufit!" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, f. 88)

Kjo do të thotë se për numrin e parë të Zërit të Kosovës, të nëntorit 1981, përveç meje e Bardhit, edhe Kadri Zeka ia ka dhënë Jusufit një artikull të OMLK-së, sa për t'ia kthyer një pjesë të borxhit sidomos për artikullin e Jusufit "Tradhtarët e rinj dhe tradhtarët e vjetër" të botuar në numrin 4-5 të Lirisë. Artikulli që Kadri Zeka ia jep Jusufit në fund të korrikut është "Planet e revizionistëve titistë për degjenerimin e rinisë sonë kanë dështuar me turp" (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, f.7-8).

22. Do t'ia bëjmë edhe ne si Lech Walesa

Të vazhdojmë leximin e letrës së Jusufit të 20 gushtit 1981.

Jusuf Gërvalla: "Maqinë për të blerë nuk kemi gjetur ende, por shpresojmë se do të **na bjerë në dorë diçka e mirë**. Tani për tani duhet të marrim, për këtë numër, një maqinë të tillë me qira. Këtu praktikohet kjo gjë." (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 451-452)

Ismet Rashiti: "Në shtator të vitit 1981, me vendim të Kadri Zekës, Hasan Mala ishte nisur për në Kosovë, ilegalisht, për ta dërguar gazetë "Liria", përmbledhjen e njohur "Këngët e lirisë" dhe literaturë tjetër të ndaluar. Paraprakisht me Kadri Zekën kishin për t'u takuar me Jusuf e Bardhosh Gërvallën, të cilët si bashkudhëtar ia caktojnë veprimtarin Haxhi Berisha. "Deri në kufirin ish-jugosllav na kanë përcjellë Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla. Pastaj unë dhe Haxhiu kemi vazhduar rrugën me tren nga Lubjana, nëpër Mal të Zi dhe kemi dalë te Kulla e Zhlebit. Me vete kishim 1400 copë të gazetës "Liria", "Këngët e lirisë" dhe shumë libra. Aty na kanë dalë shokët me veturë, e kanë marrë materialin dhe ne e kemi vazhduar rrugën, ashtu siç kemi mundur e ditur. Më vonë kam mësuar se ata tre shokë, që kishin dalë për të na pritur, ishin: Nezir Myrtaj, Naim Salihu dhe Selim Hyseni. Pas këtij aksioni, që u krye me sukses, më thirri Hydajet Hyseni, i cili ma kishte përgatitur një valixhe, ku i kishte futur Tezat e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Po këtë ditë kisha vendosur ta vizitoja vëllanë, Rexhepin, në Burgun e Zenicës, e pastaj ta vazhdoja rrugën për mërgim. U bë si u bë, u nisa dhe shkova te Rexha për vizitë në burg. Ky ishte takimi i fundit me të. E shikova në sy dhe zemra ma ndjeu se nuk do ta shihja më. U ndamë me zemër të pikëlluar. Shkova, e mora valixhen ku e kisha lënë dhe u ktheva në Zvicër bashkë me "Tezat e Frontit Popullor". Kur shkova te Kadriu, në St. Gallen, aty kishte qenë edhe Jusuf Gërvalla" – tregon për herë të parë Hasani." (Rrëfanimë lirike, Prishtinë 2010, faqe 71-72)

Në mesin e shtatorit Jusufit i bjenë në dorë diçka e mirë. Ai e blen një maqinë për përgatitjen e "Zërit të Kosovës, të markës IBM, e quajtur me emrin e plotë "**IBM Electronic Selectric Composer**". Tani jemi në kohën kur Jusufit, përveç maqinës së IBM-it, i bjenë në dorë diçka edhe më e mirë se maqina, e kjo e mirë nuk është as më pak e as më shumë se sa dokumenti i OMLK-së me titull "Teza rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës". Këto Teza të majit janë përpiluar në maj 1981. Por ajo çka është më kryesorja në këtë rast është se këto teza Jusufit i kanë ardhur në gjysmën e dytë të shtatorit 1981. Jusufi posa i ka marrë i ka rishkruar dhe radhitur mirë në maqinën e porsa blerë të IBM-it. Rishkrimi e radhitja e këtyre Tezave është e vetmja punë që është bërë për llogari të OMLK-së me maqinën e Jusufit me emrin komplet **IBM Electronic Selectric Composer**. Ky është vetëm aspekti teknik i kësaj çështje.

Në këtë kohë shumicën e ditëve të javës i kaloja në Ludwigsburg, ku banoja me Haxhi Berishën dhe Naim Haradinajn, ndërsa me Jusufin takoheshim çdo të shtune-diele. Të shtunën e parë pas ardhjes së Tezave, si kam shkue te Jusufi, në mes nesh biseda filloi në këtë mënyrë:

Jusufi: - Kam lajme shumë të mira.
Unë (Xh. D): - Pse çka ka ndodh?
Jusufi: - Do t'ia bëjmë edhe ne si Lech Walesa!
Unë (Xh. D.): - E qysh si Lech Walesa?
Jusufi: - Shikoi e lexoj këto Teza që na kanë ardhur!

Jusufi m'i dha Tezat e rishkruara e radhitura nga ai, në të cilat shkruante me sa vijon:

"TEZA RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS

I

Kriza e rëndë që ka mbërthyer Jugosllavinë revizioniste, i ka sjellë masat punonjëse kudo në Jugosllavi në një gjendje shumë të vështirë. Por, veçanërisht e rëndë dhe e padurueshme është kjo gjendje në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, ku mbi masat punonjëse po ushtrohet një shtypje e shfrytëzimit i egër e i shumëfishtë kolonial e kapitalist.

Populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi ka luftuar në shekuj për lirinë, të cilën nuk e fitoi kurrë. Megjithë gjakun e shumtë që derdhi në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, ai nuk fitoi të drejtën e tij të ligjshme dhe të premtuar që të vendosë vetë për fatin e tij. Këtë të drejtë, që më parë e kishin proklamuar vetë shovinistët e rinj jugosllavë, pas përfundimit të luftës, e mbytën me gjak. Me anë të forcës e të tradhtisë, ata bënë që Kosova dhe tokat e tjera shqiptare, që fuqitë e mëdha i kishin shkëputur padrejtësisht nga shteti shqiptar, të pushtohen përsëri dhe të copëtohen në mes të Serbisë, Maqedonisë dhe Mali të Zi. Populli i robëruar shqiptar u bë objekt i një politike të egër shoviniste të shtypjes e shfrytëzimit të pamëshirshëm, objekt i dhunës dhe terrorit, shkombëtarizimit dhe gjenocidit të paparë. Çështja kombëtare e popullit tonë mbeti një problem i pazgjidhur, një plagë që kërkon shërim. Popullit shqiptar në Jugosllavi dhe sidomos atij në Maqedoni e Mal të Zi i janë mohuar e shkelur të drejtat më elementare kombëtare.

Përveç marrëdhënieve kapitaliste në prodhim, gjendjen e masave punonjëse dhe të të gjithë popullit shqiptar në Jugosllavi e rëndon edhe shfrytëzimi i egër kolonial që ushtrohet mbi të. Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi janë shndërruar në koloni të vërteta të Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, në burim të tyre, thjesht të lëndëve të para dhe të krahut të lirë të punës. Mbi supet e klasës sonë punëtore dhe masave të tjera punonjëse po hidhen jo vetëm pasojat e krizës që ka mbërthyer ekonominë kosovare, por edhe ato të krizës së ekonomisë të të gjithë Jugosllavisë. Kjo ka bërë, që megjithë pasuritë e shumta që kanë Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi jo vetëm të jenë pjesa më e pazhvilluar në Jugosllavi, por që edhe prapambetja e tyre në krahasim me viset e tjera të Jugosllavisë të shtohet vazhdimisht. Kjo ka bërë që Kosova jonë e begatshme të mbetet "shtëpia e varfër e Evropës", vendi i prapambetjes, papunësisë, kurbetit, analfabetizmit, errësirës, sëmundjeve, skamjes dhe mjerimit

II

Populli ynë heroik ka luftuar në shekuj për lirinë dhe të drejtat e tij. Ashtu si dhe më parë, ai nuk u pajtua kurrë me zgjedhën e re të robërisë revizioniste. Luftën e pandërprerë të popullit tonë kundër zaptuesve të rinj shovinistë nuk kanë mundur ta shuajnë as gjenocidi, dhuna e terrori i egër fashist dhe as premtimet, demagogjia, feja, shturja e degjenerimi. Krahas ngritjes së vazhdueshme të ndërgjegjes kombëtare e klasore të popullit tonë të robëruar, u rrit dhe u intensifikua edhe lufta e tij për të drejta e liri.

Lëvizja revolucionare e pranverës së këtij vitit është vazhdim i drejtpërdrejtë i luftës së pandërprerë të popullit tonë për liri, dëshmi e ngritjes së saj në një shkallë akoma më të lartë.

Grevat dhe demonstratat e mëdha të pranverës nuk kishin aspak karakter shovinist, irredentist, reaksionar e kundërrivolucionar, siç po për piqet t'i paraqesë ato propaganda jugosllave. Ato ishin pasojë e gjendjes së padurueshme, në të cilën ndodhet populli ynë, e shtypjes dhe shfrytëzimit të egër kolonial e kapitalist që ushtrohet mbi masat tona punonjëse. Me anë të këtyre demonstratave dhe grevave, populli ynë kërkoi kushte më të mira jetese, kërkoi lirinë dhe të drejtat e mohuara kombëtare e demokratike; dhe në mënyrë të veçantë kërkoi që Krahinës Autonome të Kosovës t'i jepet statusi i Republikës brenda Federatës Jugosllave. Këto kërkesa qenë paqësore; të përgjakshme ato i bënë shovinistët serbomëdhenj dhe tradhtarët

shqiptarë, që urdhëruan shuarjen e tyre me armë dhe me gjak, me milici speciale, tanke dhe ushtri. Ata janë përgjegjës për gjakun që u derdh në këto demonstrata popullore dhe për të gjitha dëmet që u shkaktuan.

Suksesi i demonstratave dhe grevave të këtij viti është i jashtëzakonshëm.

* U arrit një politizim, mobilizim dhe bashkim i paparë i popullit tonë.

* U ngrit në një shkallë akoma më të lartë fryma e tij, luftarake, patriotike e klasore, u shtua edhe më shumë besimi i tij në forcat e veta të pashtershme.

* Politika antipopullore e udhëheqjes shoviniste të Jugosllavisë u demaskua e u diskreditua edhe më shumë jo vetëm në sytë e popullit tonë, por edhe në sytë e popujve jugosllavë dhe të atyre të botës. Doli në shesh jo vetëm politika e shovinistëve serbomëdhenj për fashistizimin dhe rankoviçizimin e mëtejshëm të Jugosllavisë, por edhe plani i rrezikshëm që ata po kurdisin në bashkëpunim me socialimperialistët sovjetikë – kundër popujve të Jugosllavisë dhe të Ballkanit.

* Çështja e Kosovës u popullarizua edhe më shumë në të gjithë botën. Lufta jonë e drejtë fitoi simpatinë dhe përkrahjen e të gjitha forcave përparimtare në të gjithë botën...

III

Të tmerruar nga goditjet dërmuese që morën nga grushti i ngritur i popullit, shovinistët serbomëdhenj kanë shpërthyer tani një fushatë të tërbuar antishqiptare. Ata po përdorin të gjitha mjetet dhe metodat, me qëllim që të shkatërrojnë lëvizjen komuniste e patriotike, që po rritet e forcohet vazhdimisht, ta nënshtrorjnë popullin tonë të pamposhtur, ta mbysin luftën e tij çlirimtare, e madje edhe të na i rrëmbejnë ato pak liri e të drejta që i kemi fituar me gjak e sakrificë. Por, siç ka treguar historia jonë e lavdishme dhe siç po e tregon edhe lufta e gjithnjë në rritje që po bën populli ynë edhe në këto kushte, nuk ka forcë në botë që mund ta mposhtë popullin tonë të paepur, që të ndalë marshimin e tij të pandalshëm drejt lirisë e socializmit.

* Në këto kushte, **para gjithë lëvizjes komuniste**, patriotike e revolucionare në Kosovë del detyrë e ngutshme bashkimi dhe organizimi më i mirë i gjithë popullit tonë dhe luftës së tij të drejtë.

* **Organizata Marksiste – Leniniste** e Kosovës mendon se në kushtet e tanishme kjo mund të arrihet më së miri duke organizuar **FRONTIN POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS**.

IV

* Qëllimi i Frontit për Republikën e Kosovës është që Krahina e Kosovës të çlirohet nga sundimi i Serbisë dhe të fitojë statusin e republikës brenda federatës jugosllave

* Kërkesa për Republikën e Kosovës është e drejtë dhe përkrahet nga i gjithë populli shqiptar

* Populli i Kosovës kurrë nuk ka vendosur për fatin e vet. Tokat e tij janë pushtuar me forcë, janë copëtuar dhe në kundërshtim me vullnetin e tij, i janë aneksuar Serbisë. Në mbledhjen e AVNOJ –it ku u vunë themelet e pushtetit të sotëm jugosllav, nuk u fol fare për çështjen e popullit shqiptar në Jugosllavi dhe më të nuk morri pjesë asnjë delegat shqiptar.

* Populli shqiptar jeton në tokën e tij, ku ka jetuar brez pas brezi.

* Populli shqiptar në Kosovë i ka të gjitha karakteristikat që përbëjnë një popull dhe një komb. Ai nuk është "pakicë kombëtare", nuk është "kombësi" dhe as "popullsi" ("narodnost"), siç e kanë cilësuar shovinistët jugosllavë. Ai përbën mbi 80 për qind të popullsisë së përgjithshme të Kosovës.

* Për nga numri i banorëve, Krahina e Kosovës është rreth tri herë më e madhe se Mali i Zi, që ka republikën e vet.

* *Republika e Kosovës do ta bëjë të mundshëm zhvillimin sa më të shpejtë ekonomik dhe kulturor të Kosovës si dhe afirmimin e mëtejshëm kombëtar të të gjithë popullit shqiptar në Jugosllavi.*

* *Republika e Kosovës do të jetë fitore e madhe edhe për popullin shqiptar në Maqedoni, në “Serbinë e ngushtë” dhe në Mal të Zi, prandaj edhe përkrahet prej tij.*

* *Republika e Kosovës nuk u sjell asnjë të keqe popujve jugosllavë dhe federatës së tyre; përkundrazi ajo është dhe në interes të tyre dhe e forcon Federatën jugosllave.*

* *Kërkesa për Republikën e Kosovës është një e drejtë që buron edhe nga Kushtetuta e Jugosllavisë, një e drejtë që e gëzojnë të gjithë popujt e tjerë në Jugosllavi. Dënimet që u jepen përkrahësve të kërkesës për Republikën janë të paligjshme.*

* *Kërkesa për Republikën e Kosovës nuk është kërkesë për ndryshimin e kufijve në Jugosllavi e Ballkan. Ajo nuk është në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara as me vendimin e Helsinkit dhe nuk sjell kurrfarë rreziku për paqen në Ballkan.*

V

* *Për t’ia arritur këtij qëllimi, Fronti duhet të bashkojë në luftë për Republikën të gjitha masat popullore, punëtorët, fshatarët, zejtarët, rininë, gratë, inteligjencën revolucionare dhe elementë përparimtarë nga radhët e borgjezisë; të gjithë komunistët, patriotët dhe revolucionarët e vërtetë, pavarësisht nga bindjet politike e nga dallimet klasore, fetare e krahinore.*

* *Fronti Popullor për Republikën duhet të jetë jo një koalicion i paqëndrueshëm i krerëve të forcave të ndryshme politike, por një bashkim luftarak i pathyeshëm i të gjitha masave tona popullore; jo marrëveshje me fjalë në letër, por një bashkim në luftë e sipër; jo qëllim në vete, por një levë e rëndësishme për edukimin, mobilizimin dhe organizimin e masave popullore në luftë për të drejta e liri*

* *Bazë e Frontit duhet të jetë aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të pararojës marksiste leniniste të vërtetë, që do të dalë nga lëvizja komuniste në Kosovë, e cila po rritet, bashkohet e forcohet çdo ditë.*

* *Në Frontin për Republikën do të bëjnë pjesë të gjitha organizatat dhe grupet ilegale komuniste, patriotike e revolucionare, pavarësisht nëse janë ose jo për socializmin e vërtetë. Republika e Kosovës është në interes të të gjithë popullit të Kosovës, në interes të të sotmes dhe të së ardhmes së tij, prandaj në Front duhet të bëjnë pjesë të gjithë ata që janë për lirinë e Kosovës, për Republikën e saj.*

* *Në Frontin për Republikën mund të bëjnë pjesë edhe shqiptarët që jetojnë jashtë Kosovës, në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, në viset e tjera të Jugosllavisë apo kudo në botë. Fronti do të luftojë për lirinë dhe të drejtat e të gjithë shqiptarëve në Jugosllavi.*

* *Republika e Kosovës është në interes edhe të popujve joshqiptarë në Kosovë, prandaj edhe ata duhet ta përkrahin kërkesën për Republikë dhe të përfshihen në radhët e Frontit.*

* *Fronti Popullor për Republikën e Kosovës nuk do të ketë asgjë të përbashkët, por do të jetë kundër LKJ-së dhe organizatave tradhtare të masave si LSPP, LRS, LS, KKASHG etj., që janë vegla të shovinizmit serbomadh. Fronti do të luftojë për demaskimin dhe izolimin e udhëheqjeve të tyre tradhtare dhe për tërheqjen në anën e tij të masave të mashtruara e të manipuluar prej tyre.*

* *Në Frontin për Republikën nuk mund të bëjnë pjesë gjithashtu as grupet e organizatat fashiste e terroriste dhe agjenturat e ndryshme, që organizon reaksioni i jashtëm apo i brendshëm.*

VI

* Krahas luftës për Republikën, Fronti do të punojë edhe për organizimin e luftës në çdo ndërmarrje, fshat, shkollë e fakultet, për mbrojtjen e të drejtave kombëtare, politike, ekonomike e shoqërore të klasës punëtore, fshatarësisë, rinisë, gruas, inteligjencës etj., për organizimin e rezistencës kundër plaçkitjes së pasurive të Kosovës, të luftës për mbrojtjen e kulturës materiale e shpirtërore të popullit tonë etj.

* Për realizimin e qëllimeve të tij, Fronti do të përdorë të gjitha format e luftës dhe organizimit, do t'i kombinojë e zëvendësojë ato në përputhje me kërkesat e situatës dhe të strategjisë së tij.

* Në veprimtarinë e tij, Fronti do t'i japë përparësi organizimit dhe luftës ilegale, por krahas kësaj ai do t'i shfrytëzojë gjerësisht edhe të gjitha format e mundshme legale.

* Fronti është kundër reformizmit dhe legalizmit borgjez dhe, nga ana tjetër, lufton kundër pikëpamjeve dhe metodave anarkiste e terroriste të luftës, të cilat e dëmtojnë rëndë dhe e komprometojnë luftën tonë të drejtë.

* Fronti do të luftojë kundër përpjekjeve për përçarjen e popullit tonë me anë të fesë, hakmarrjes, vëllavrasjes etj.

* Fronti do të luftojë kundër përpjekjeve për armiqësimin e popullit shqiptar në Jugosllavi me Shqipërinë socialiste. Ai do t'i popullarizojë sukseset madhështore që po arrin në të gjitha fushat Shqipëria socialiste nën udhëheqjen e Partisë së Punës dhe të shokut Enver Hoxha. Fronti do të përpiqet për zhvillimin e marrëdhënieve sa më të ngushta e të gjithanshme mes popullit shqiptar në Jugosllavi dhe atij në Shqipëri.

* Fronti Popullor për Republikën e Kosovës do të luftojë gjithashtu edhe kundër përpjekjeve të shovinistëve serbomëdhenj për ta armiqësuar popullin shqiptar me popujt jugosllavë në Kosovë dhe në Jugosllavi. Fronti nuk i ngatërron popujt jugosllavë me krerët e tyre shovinistë. Luftën e tij ai jo vetëm që nuk e drejton kundër proletariatit dhe popujve jugosllavë, por përkundrazi, ai i konsideron ata si aleatë të tij në luftën për të drejta e liri.

* Duke ndjekur një politikë konsekuente internacionaliste, Fronti do ta lidhë luftën e tij me luftën që bëjnë popujt dhe proletariati i të gjithë botës për liri e socializëm dhe do të luftojë kundër imperializmit me atë amerikan në krye, kundër socialimperializmit sovjetik, kundër fashizmit dhe reaksionit të të gjitha ngjyrave.

* * *

Këto janë tezat kryesore që **Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës** i propozon si bazë për organizimin e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Gjatë diskutimit ato me siguri që do të plotësohen, të përsosen e kristalizohen më tej dhe mbi këtë bazë do të përcaktohet vija politike, ideologjike e organizative e Frontit.

Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës u bën thirrje të gjithë **komunistëve**, patriotëve e revolucionarëve të organizuar e të paorganizuar që t'i përgjigjen ashtu si duhet thirrjes së Atdheut për bashkimin e Frontit të përbashkët të luftës për të drejtat dhe lirinë tonë – për Republikën tonë.

Forca jonë qëndron në unitetin tonë. Sa herë që populli ynë ka bashkuar armët dhe zemrat në një front të vetëm, ai ka arritur të mposhtë dhe të mbulojë me turp armiq shumë më të mëdhenj e më të armatosur. Këtë e dëshmojnë luftërat legjendare të Skënderbeut, e dëshmon lufta e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e dëshmon epopeja e lavdishme e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, e dëshmojnë edhe grevat e demonstratat tona heroike.

Në luftë për të drejtat tona, ne, gjatë kësaj pranvere, pavarësisht se cilës organizate i takonim, u lidhëm sup më sup dhe, si shokë e vëllezër të vërtetë, luftuam, u përleshëm e u gjakosëm me armiqtë dhe tradhtarët e urryer të popullit tonë. Tani para nesh shtrohen detyra që këtë bashkim të paparë që arritëm në luftën tonë, ta ruajmë e forcojmë më te, ta bëjmë të organizuar, të

*qëndrueshëm, të pathyeshëm, të përjetshëm. Bashkimi bën fuqinë. Bashkimi është imperativ i kohës. Të bashkuar e të lidhur si vëllau me vëllanë, ne jemi më të fuqishëm se të gjithë armiqtë tanë, të bashkuar ne jemi të pamposhtur. Vetëm të bashkuar si grusht i vetëm në **Frontin** Popullor për Republikën e Kosovës, ne do të arrijmë fitoren tonë, lirinë tonë.*

Rroftë Fronti Popullor për Republikën e Kosovës Organizata Marksiste – Leniniste e Kosovës'' (Teksti i Tezave, është marrë nga libri i Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 208-213)

Pas radhitjes, Jusufi i shumëzoi këto teza, i dërgoi një numër ekzemplarësh Kadri Zekës në Zvicër dhe vet i shpërndau në krejt rrethin e Shtutgartit. Bashkimi shikohej si një çështje dite, bisedat dukej se do të ishin vetëm formalitet me një procedurë shumë të shkurtër. Jusufi kurrë nuk do të përshkruante (radhiste) ato teza e t'i shpërndante sikur të mos pajtohej pikë për pikë me pikëpamjet e tyre.

Ibrahim Kelmendi nuk ishte i involvuar në këtë punë sa i përket pjesës së Jusufit, siç e dëshmon letra e 20 gushtit. Se në çfarë mase ka qenë i involvuar nga ana e Kadri Zekës do ta shohim më vonë.

23. Ndoshta pikërisht nga radhët e tyre

Jusufi qoftë me shtypjen e shpërndarjen e Tezave qoftë gojarisht ia shpreh Kadri Zekës përkrahjen e vet të pa rezervë për Tezat e majit. Tani në kohë jemi në gjysmën e dytë të shtatorit. Se sa arsye të madhe ka Jusufi të pajtohet e të jetë i kënaqur me këto Teza, duket më së miri nga artikulli i tij programatik "Bashkimi bën fuqinë", nga dhjetori 1980, ku shkruan:

Jusuf Gërvalla: "*Fronti i Kuq Popullor, i themeluar prej forcash patriotike, pret themelimin e partisë sonë komuniste marksiste-leniniste e cila do të vihet në ballë të luftës dhe të revolucionit. Sipas vlerësimeve të Frontit, arsyeja për këtë inversion qëndron në kushtet konkrete, të cilat kanë ndikuar që forcat patriotike të masave të gjëra të ecin një hap përpara organizimit të komunistëve tanë. Në kësi konteksti e shohim aktivitetin e Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe të Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi - një organizatë e hershme, që ka mbledhur dhe mban rreth vetes njerëz me eksperiencë patriotike e revolucionare dhe me të cilën jemi duke bërë përpjekje për njohje reciproke dhe për bashkim. Në kësi konteksti jemi duke përcjellë gjithashtu edhe aktivitetin e Marksist-leninistëve të Kosovës, që po shfaqen këto kohët e fundit me organin e tyre "Liria". Duke u nisur nga kryeartikulli në numrin e parë të këtij organi, si dhe nga përmbajtja e tij përgjithësisht e nga trajtimi marksist-leninist i problemeve nga ana e krijuesve të "Lirisë", ne e vlerësojmë shumë të drejtë punën e Marksist-leninistëve kosovarë. Kjo na jep shpresë që së shpejti, ndoshta pikërisht nga radhët e tyre, do të realizohet edhe kërkesa e domosdoshme për themelimin e vetë partisë komuniste marksiste-leniniste."* (Bashkimi - organ i Frontit të Kuq Popullor, nr.1, janar 1981, faqe 2, shtylla 1)

Bisedat e komunikimit e Jusufit dhe Kadri Zekës në këtë çështje mund të përmbliidhen kështu:

K. Zeka: Si t'u dukën Tezat?

Jusufi: Shumë të mira, gjërat nuk mund të thuhesh më qartë e më mirë.

K. Zeka: Atëherë mund të bashkohemi duke u bazuar në Tezat!

Jusufi: Patjetër, çështjen e bashkimit e shikoj më tepër teknike dhe formale.

K. Zeka: Është mirë të bashkohemi e të formohet Fronti sa më parë!

Jusufi: Është mirë të bashkohemi e të formohet Fronti dhe struktura organizative siç parashtrohet në Teza!

K. Zeka: Atëherë çka presim?!

Jusufi: Atëherë çka presim?!

Tezat, Jusufi i ka kuptuar në këtë formë:

- Formimi i partisë pararojë (Partisë Komuniste) e cila do ta udhëheqë Frontin,
 - Në Partinë Komuniste do të hyjnë kuadrot më të formuara dhe më të dëshmuara.
- Këtë lloj interpretimi e ka lënë të nënkuptohet Kadri Zeka gjatë kontakteve me Jusufin. Kadri Zeka nuk e ka bërë asnjë koment të vetëm shtesë para Jusufit, se si duhet kuptuar tezat në të vërtetë. Duke u sjellë në rreth, sa i përket kësaj çështje, pasi Kadri Zeka dhe shokët e tij nuk pranojnë biseda konkrete për bashkim me Jusufin edhe pse ai është i autorizuar për këtë nga Sabri Novosella, Jusufi i thotë Kadriut, se unë me Tezat pajtohem por për t'u sqaruar konkretisht është shoku më kompetent i LNÇKVSHJ, Sabri Novosella, që gjendet në Turqi. Ti e ke përkrahjen time, me vete i merr Tezat që ua kam radhitur, dhe përveç kësaj si shok të rrugës që të mos mërzhitesh e ta kesh krah po ta jep Bardhin.

24. Atje ku duket se ka pasur pasivitet ose harresë

Kadri Rexha: *"Së pari kishte ndërprerë daljen e revistës "Lajmëtari i lirisë" dhe me të gjitha forcat e veta ishte përqendruar në botimin e revistës "Liria" dhe në organizimin e demonstratave të përbashkëta. Më në fund, po për këtë qëllim ai e kishte hedhur poshtë edhe idenë e formimit të komiteteve për Kosovën në botën e jashtme. Lidhur me disa punë që në atë kohë Jusuf Gërvalla autorizohej t'i kryente, ai vazhdimisht përmes përfaqësuesit të degës "Hasan Prishtina" i këshillonte shokët që para se të shtronin detyra përkatëse ta kishin parasysh edhe nevojën e bashkimit: "Edhe kjo punë mund të vazhdojë po e patë ju të arsyeshme – u drejtohej shokëve të vetë Jusuf Gërvalla - por mendoj se kur merrni vendime për çështje të tilla, duhet ta mbani parasysh edhe rrethanën e nevojës së madhe të bashkimit, duke u prirë nga mendimi se me bashkim nënkuptohet bashkimi i mendimeve, i pikëpamjeve dhe i punëve të përafërta a identike të dy a më shumë organizatave. Atje ku duket se ka pasur pasivitet ose harresë nga unë, atje kryesisht ka qenë vendimtar ky parim dhe më pak harresa ose pasivizimi."* (Fati i luleve, Prishtinë 1993, faqe 202)

Kadri Rexha: *"Në këtë takim, të mbajtur në tetor të vitit 1981, pala e MLK-së, e përfaqësuar nga Kadri Zeka, çështjen e bashkimit e sheh në dritën e formimit të një partie komuniste marksiste-leniniste, radhët e të cilës do të përbëheshin nga anëtarët e organizatës MLK dhe nga ndonjë komunist i verifikuar nga radhët e organizatës LNÇKVSHJ. Sipas kësaj pale kjo parti duhej të konsiderohej si pararojë dhe udhëheqëse, ndërsa organizata LNÇKVSHJ konsiderohej si front i gjer i luftës. Qëndrimin e mësipërm pala e LNÇKVSHJ e përfaqësuar nga Sabri Novosella, nuk e pranoi, meqë bashkimin e kishte parë në dritën e barabarësisë së plotë të grumbullimit të forcave patriotike në frontin e luftës për liri kombëtare, në radhë të parë. Kështu edhe bisedimet e para lidhur me çështjen e bashkimit të këtyre organizatave përfunduan me mospasurë."* (Fati i luleve, Prishtinë 1993, faqe 202-203)

Ibrahim Kelmendi: *"I dashur shoku Mërgim (Sabri Novosella - shën. im),*

"...Gjatë takimeve që kishim, disa herë u sjellën bisedimet te bisedat në mes teje e shokut Zeqë (Kadri Zekës - shën im). Lidhur me atë takim, mendoj, duhet të na informosh, pak më shumë se sa i ke shkruar "heroit" (Jusuf Gërvallës shën im). Them kështu pasi disa fjalë shpëtuan gjatë fjalosjes mes teje e shokut Ujkan, prandaj, pos arsyerave tjera, edhe që të mos lejohet mundësia për manipulim me fjalët që nuk janë inçizuar as mbajtur shënime. Sidomos do ndihmonte shumë informimi yt, pasi, me gjasë, vetëm ti je ndër të gjallët, që mund të informosh mbi bisedimet, ashtu siç janë zhvilluar." (Letër Sabri Novosellës, 17 janar 1984)

25. Pse ke ardhur?

Rreth 12 tetorit 1981 Kadriu dhe Bardhoshi udhëtojnë me aeroplan në Stamboll për çështje të "bashkimit" - bishtëzimit. Dëshmitari i gjallë i këtyre takimeve Sabri Novosella ka shtrembëruar çdo fjalë sa i përket këtij takimi.

Sabri vazhdon: "*Unë dhe Bardhoshi dolëm me qëndrimet e Organizatës që përfaqësonim: Të bashkohemi në një organizatë të vetme e cila mund të quhej Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi*". (Zëri, 28 mars - 4 prill 1992)

Sabri Novosella: "*Me atë rast, unë dhe Bardhoshi i shtruaam qëndrimet e organizatës të cilës i takonim, ndërsa Kadri Zeka qëndrimet e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës. Gjatë kësaj bisede procesverbalin e mbajti Bardhoshi, andaj të gjitha këto që po i them unë tashti janë të shënuara në shkrimin e tij. LNÇ e Kosovës doli me qëndrimin që të gjitha organizatat ekzistuese politike në Kosovë dhe jashtë të bashkoheshin në kuadër të një Lëvizje të vetme, me një Program, një Statut dhe një Platformë sipas të cilës mendonim se si fazë të parë, duhej luftuar për një Republikë Shqiptare në kuadër të Jugosllavisë. Kurse OMLK-ja i kishte edhe tezat e shkruara (e rishkruara nga Jusufi - shën im) dhe angazhohej për një front, i cili do t'i bashkonte të gjitha grupet dhe organizatat, kurse në ballë të kësaj Lëvizjeje, apo fronti, të vihej pikërisht Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës e cila duhet ngritur në Partinë Marksiste-Leniniste të Kosovës. Ne nuk pranuan një gjë të tillë me arsyetimet tona dhe bindjen tonë se ishim të detyruar që të gëzonim përkrahjen edhe të shteteve tjera e në veçanti të shteteve tradicionalisht mike të kombit shqiptar si Gjermania, Austria, Hungaria, Turqia etj.*" (Intervistë në Zëri e ribotuar në Drita, Trelleborg-Suedi, nr. 10/1997)

Sabri Maxhuni - Novosella: "*Me shpresë se do të arrihej bashkimi i organizatave në një Lëvizje Kombëtare, ku do të bashkohen veprimtarët, pavarësisht nga përcaktimet e tyre politike, isha përgatitur t'i prisja përfaqësuesit e OMLK-së. Në Aeroportin e Stambollit dola për t'i pritur së bashku me Sabri Kosovën, duke besuar se do të vinte edhe Jusuf Gërvalla, por Jusufi nuk pati mundësi të vinte për shkak të dokumenteve të udhëtimit ende të parregulluara. Ishte vendosur të vinte Bardhosh Gërvalla. Në aeroport arritën Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla. U habita kur e pashë vetëm Kadri Zekën si përfaqësues të OMLK-së. Bardhoshi më tha se Kadriu kërkon që shoku që më shoqëronte të mos merrte pjesë në bisedime. Edhe përkundër dëshirës, e pranova propozimin.*

U vendosëm në një hotel të Stambollit dhe pas një pushimi disaorësh i filluan bisedimet, unë dhe Bardhoshi, si përfaqësues të LNÇKVSHJ-së dhe Kadri Zeka, si përfaqësues i OMLK-së. Unë dhe Bardhoshi dolëm me propozim që të bashkohemi në një Lëvizje Kombëtare, pavarësisht përcaktimeve politike duke u mbështetur në qëllimin kryesor, çlirimin dhe bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare dhe bashkimin me shtetin shqiptar, respektivisht krijimin e shtetit shqiptar brenda kufijve të vet kombëtarë. Kadri Zeka i kishte sjellë "Tezat për krijimin e frontit popullor të Kosovës". Unë dhe Bardhoshi i lexuam ato teza me vëmendje të posaçme. Tezat ishin të qarta: kërkohej bashkimi i të gjitha organizatave dhe grupeve politike në një front, i cili do të udhëhiqej nga Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës, e cila duhej të ngrihej në Parti Marksiste-Leniniste të Kosovës. Në të vërtetë, kjo ishte kopje identike e ndërtimit të piramidës shtetërore në Shqipërinë komuniste. Dhe, tragjedia qëndron pikërisht këtu: këtë ndërtim piramidial dëshironin ta bartnin në organizimin e emigracionit shqiptar në Perëndim!?

Gjatë tri ditëve u debatua me orë të tëra. Unë dhe Bardhoshi sillnim argumente se duhej një Lëvizje Kombëtare që do ta gëzonte përkrahjen e shteteve evropiane dhe të botës perëndimore në përgjithësi dhe të shteteve ku vepronin, siç ishin Turqia, Gjermania, Zvicra.

Kadriu pohonte se si fitorja e proletariatit ndërkombëtar është e paevitueshme dhe se, sipas tij, e vetmja ideologji e drejtë është ideologjia marksiste-leniniste. Vetëm komunistët janë të denjë për ta udhëhequr luftën për çlirimin e Kosovës.

Kadriu propozoi që Metushi të jetë kryetar i Frontit Popullor të Kosovës, por gjithsesi komunistët duhet ta kenë Partinë Komuniste të Kosovës." (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010, faqe 154-156)

Jusufi nuk ka përgatitur asgjë me shkrim për bisedimet e Stambollit të tetorit 1981, as Bardhoshi nuk i ka thënë asnjë fjalë për ndonjëfarë Lëvizje për Republikë apo Kombëtare. Jusufi është pajtuar me germën dhe me frymën e Tezave rreth Frontit për Republikë, ashtu si ai i ka lexuar ato dhe si ua ka përcjellë vetë të tjerëve. Në Stamboll, gjatë bisedimeve Kadriu jep sqarimin e vetë konkret e lakuriq se si duhet lexuar tezat:

- Jo parti pararojë (Jo Parti Komuniste Marksiste-Leniniste) e përbërë nga anëtarë të organizatave të tjera, por vetëm nga radhët e OMLK-së,
- vetëm anëtarët e OMLK-së janë marksistë, komunistë të formuar,
- në organizatat tjera të tillë nuk ka, prandaj të tjerët - në Front për Republikë, nën udhëheqjen e OMLK-së.

Bardhoshi u kthye nga Stambolli me sa më kujtohet të premten në mbrëmje më 16 tetor 1981. Në këtë datë bazohem në faktin se Panairi i librit i Frankfurtit, në vitin 1981 është mbajtur prej 14 (e mërkure) deri më 19 (e hënë) tetor 1981. Me Jusufin dhe shumë shokë të Shtutgartit ishim organizuar të shkonim në Panair. Por, Panairi në ditët e para (e mërkurë, e enjte dhe e premte) është i rezervuar vetëm për konferenca e tubime për ata që kanë ftesa e rezervime për ligjërata të ndryshme, ndërsa të shtunën dhe dielën është i hapur për të gjithë. Kështu, saktësisht në ditën e parë të hapjes së Panairit të librit në Frankfurt, për publikun e gjerë, dhe pikërisht, në kerr, në autostradë, gjatë rrugës për në Frankfurt, Bardhi na e shpjegoi mua e Jusufit rrjedhën e bisedimeve në Stamboll, ndeshjen e cakërrimet frontale rreth Frontit, në mes Kadri Zekës dhe Sabri Novosellës. Jusufi rrjedhën e këtyre bisedimeve e kishte dëgjuar qysh të premten në mbrëmje, por kishte dëshirë që Bardhi ta përsërit tregimin e tij edhe në praninë time e për mua.

Bardhoshi tregoi se bisedimet në mes Sabri Novosellës e Kadri Zekës sa i përket bashkimit ishin të shkurta, dhe u ndërpre në shumë shpejt pasi Kadri Zeka tha se nuk ka ardhë të bisedoj për bashkim.

Thelbin e bisedimeve ai e tregoi me këto fjalë:

S. Novosella: Mund të fillojmë bisedimet për çka jemi mbledhur, bisedimet për bashkimin e organizatave në një të vetme?

Kadri Zeka: Ne jemi për krijimin e një Fronti në bazë të këtyre tezave, i cili do të udhëhiqet nga OMLK!

S. Novosella: Ne kemi menduar se do të vish për çështjen e bashkimit të organizatave. Është çështja e këtyre bisedimeve për shkak të të cilave ne e kemi pezulluar nxjerrjen e "Zërit të Kosovës" që disa muaj!

K. Zeka: Unë nuk kam autorizim me bisedua për bashkimin më shumë se ajo që thash, e që është në teza!

S. Novosella: Atëherë pse ke ardhur?

K. Zeka: Që të shihemi!

S. Novosella: Sa për t'u parë, mua më shumë më ka marrë malli për familjen time që nuk i kam pa qe dy vjet.

K. Zeka: Jusufi nuk pajtohet me ty, ai është krejtësisht në pozitë të Tezave

tona. Këto teza që po i sheh në tavolinë janë të radhitura e rishkruara nga Jusufi.

S. Novosella: Jusufi pajtohet me mua dhe jo me ty.

K. Zeka: Ty ka me të dalë punë me Jusufin!

S. Novosella: Jo mua po ty ka me të dalë punë me Jusufin kurrë ta merr vesh thelbin e interpretimit të këtyre tezave që nuk ke guxua me ia bërë atje, por ke ardhë tek unë.

K. Zeka: Çka jeni kapë aq shumë pas atij njeriu?

S. Novosella: Është punë për ne për kend kapemi. A jam duke të pyetur unë ty se pse je kapë aq shumë pas këtij apo atij njeriu?!

Bardhi tregon se gjatë kthimit, Kadriu ishte si një tjetër njeri. Atij dhe shokëve të tij më të ngushtë iu kishte ra sharra në gozhdë tepër keq. LNÇKVSHJ-a u kishte dalë kafshatë që nuk kapërdihet aq lehtë. Për dallim nga Kadri Zeka, Bardhi nuk e ka ndier vehten për asnjë moment keq nga kjo rrugë, edhe "*pse Sabri Novosella sillet shumë keq jo vetëm ndaj Kadri Zekës por edhe shokut të Organizatës së vetë Bardhoshit.*"

Duhet të ketë thirrur me histerizëm në drejtim të Kadriut!

Në vend të përshëndetjes mirëseardhëse Sabri Novosella duhet të ketë thirrur me histerizëm në drejtim të Kadriut: "*Nuk pranoj të bisedoj me një komunist si ju të OMLK-së!*"

I. Kelmendi: "*Kur shkuan në Turqi Kadri Zeka e Bardh Gërvalla për t'u takuar me Sabitin, në tetorin e vitit të kaluar, në vend të përshëndetjes mirëseardhëse, Sabiti duhet të ketë thirrur me histerizëm në drejtim të Kadriut: "Nuk pranoj të bisedoj me një komunist si ju të OMLK-së!"*" (Atentatet, f. 387)

Sipas skenarit të figurës frontale të Frontit të UDB-së, Sabri Novosella është **dashtë** t'i drejtohet me histerizëm Kadriut, por kështu nuk ka ndodhë. Kurrë nuk ma ka marrë mendja se debati apo falsifikimi i ngjarjeve të bëhet e të bjerë deri në këtë nivel sa primitiv aq edhe qesharak.

Sipas kësaj logjike (jo perverse) rrjedh se gjuhë të përbashkët, mirëkuptim e biseda të këndshme pune me komunistin Kadri Zeka, ka mundë të bëjë vetëm armiku i diktaturës komuniste dhe i sistemit komunist, I. Kelmendi.

Kur e paska marrë vesh Sabri Novosella se Kadri Zeka është anëtarë i OMLK-së, e komunist? Sipas kësaj del se ai këtë nuk e paska ditë derisa u takua me Kadriun në Stamboll, se Jusufi nuk e paska informuar Sabriun se Kadriu po vjen tek ti, si komunist e si anëtarë i OMLK-së.

Prapë se prapë unë e kuptoj se për çështje ideore e ideologjike nuk është punë e lehtë të merresh me Sabri Novosellën për shkak të stabilitetit të palëkundur në këtë drejtim dhe njohurive të tij të thella. Por është një aspekt tjetër shumë më konkret që e bënë Sabri Novosellën ndër personat më të përsosur dhe ai është aspekti ekonomik, tregtar. Po të kishte pas asi parimi Sabriu, që të mos flas me komunist, atëherë ai kurrë nuk kishte me e lejuar atë (Kadriu) të tregohet aq i pakujdesshëm me të hollat e fituara nga puna e tij, kurrë nuk kishte me e lejuar të harxhohej kot deri në Stamboll, ta bënte gjithë atë troshak kot së koti. Sabriu qysh atëherë ka qenë i kujdesshëm të mos e harxhoj askënd, as t'i lodhë të tjerët që fjalët e tij t'i mbledhin si trohët e bukës në sofër. Kujdesi për trohët e bukës në sofër, për mos me ba troha kot së koti, i Sabri Novosellës është i patejkalueshëm.

Thelbi i prishjes së Sabriut me Kadri Zekën në Stamboll qëndron në faktin se Kadri Zeka e ka fyer Sabriun duke i thënë se ai (Sabriu) nuk është komunist i modës sikurse që janë ai vetë (Kadri Zeka), Mehmet Hajrizi e Brat Berat Luzha. A ka fyerje më e rëndë e ulje e reputacionit se sa ta akuzosh një rrobaqepës të klasit të parë se nuk din çka është moda, se nuk është në gjendje ta përcjellë modën.

Saime Isufi: "Më 18 tetor të vitit 1981, u nisa përsëri për në Zvicër. Kadriu nuk ndodhej në Zvicër. Ai kishte qenë në panairin e librit në Frankfurt dhe **pastaj kishte udhëtuar me Bardhosh Gërvallën në Turqi**, për bisedime rreth bashkimit të organizatave me udhëheqësin e LNÇKVSHJ, Sabri Novosellën. Në banesën e tij na priti Hasan Malaj, mua dhe Berat Luzhën. Me Hasanin, që atë natë udhëtua dikur në Gjermani për të marrë Kadriun. U takuam me Kadriun. Dukej shumë i lodhur, i rraskapitur, por edhe i dëshpëruar nga takimi që kishte pasur me Sabri Novosellën.

Ai nuk i kishte përfillur, bile i kishte fyer e poshtëruar atë dhe Bardhosh Gërvallën." (Apostol Duka, Vrasje në Shtuttgart, f .98)

Kjo informatë është shumë domethënëse. Kadri Zeka, pas kthimit me Bardhin nga Stambolli, nuk shkon në Zvicër, po drejtë e në Gjermani tek Ibrahim Kelmendi.

Ismail Kadare: "Në mbarim të vitit 1981 në panairin ndërkombëtar të librit në Frankfurt të Gjermanisë Perëndimore, pata rastin të takoj për herë të parë e të fundit shkrimtarin, gazetarin dhe personalitetin e shquar të Kosovës, Jusuf Gërvallën. Erdhi te stenda e librit shqiptar së bashku me të vëllanë një ditë shiu, pa rënë fare në sy, midis dhjetëra vizitorëve. Trupmesatar, gjysmëbiond ai kishte në tërë qenien e tij atë lloj thjeshtësie dhe paraqitjeje të zakonshme, pas të cilës ndihet menjëherë thellësia dhe e pazakonshmja.

Biseduam gjatë atë ditë midis rrëmujës së panairit dhe pastaj më gjatë në mbrëmje në një kafe të qytetit. Poet, prozator, publicist militant, Jusuf Gërvalla kishte të gjitha cilësitë dhe dimensionet që e bëjnë të shquar një personalitet të letrave e të kulturës. Për fat të keq mundësitë e tij mbetën të pashprehura plotësisht." (Jusuf Gërvalla, Rrotull, Tiranë 1983, faqe 3)

26. A vlejné këto fjalë edhe për mua?

Mund të thuhet se shkak i ndaljes së Kadri Zekës në Gjermani është Panairi i librit në Frankfurt. Por kjo nuk është krejt e vërteta. Ai (Kadriu) ndalet dhe shkon në Gjermani, që Ibrahim Kelmendin dhe Frontin e tij të Kuq t'ia bashkoj OMLK-së e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Pra atë punë që nuk ka mund ta kryej e ta bëjë me Sabri Novosellën ta kryej me Ibrahim Kelmendin.

Saime Isufi: "Kadriu nuk ndodhej në Zvicër. Ai kishte qenë në panairin e librit në Frankfurt dhe **pastaj kishte udhëtuar me Bardhosh Gërvallën në Turqi**, për bisedime rreth bashkimit të organizatave me udhëheqësin e LNÇKVSHJ, Sabri Novosellën."

Hasan Mala: "Kur është kthye Kadriu prej mbledhjes (në Stamboll - shën i Xh. D.) që kanë pas, unë kam qenë në panairin e librit në Frankfurt. Ishte edhe Ismail Kadareja, ishte edhe Isufi aty. Pak a shumë u njëfishim me Isufin, por jo sa duhet. Kisha një respekt ndaj tij, ishte njeri i afërt. Vjen Kadriu aq i lodhur e aq i mërziur sa nuk mundet me u marrë me mend, dhe më kapi për krahu e u ulëm rreth një tavoline.

- Çka u bë puna si kaluat atje?

- Kurrqysh hiq nuk kemi kalue!

- Si?

- Nuk kemi mund të bëjmë asgjë, por frikohem se është prishë puna edhe më shumë.

- Po Bardhi si mendon?

- Bardhi nuk mendon keq, Bardhi, por megjithatë, kur ishte ndikimi i tij (Sabri Novosellës - shën im), para tij nuk e thoshte ndoshta edhe atë çka e mendonte, se Sabriu kishte më kompetencë. Por Isufi më la përshtypje të mirë, - se i ka folë Isufit aty.

Isufi i ka thënë se pse nuk është arritë atje, mund të kryhet nesër. Domethënë mund të bëhet

nesër, nuk do të thotë se u krye (mori fund - shën im) kjo punë. Isufi e ka pritë me rezervë, domethënë pse s'u bërë mirë tani, por në të ardhshmen do të bëhet mirë." (Marrë nga filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?", 1997)



Bundesarchiv, B 145 Bild-F061580-0014
Foto: Hoffmann, Harald | 14. Oktober 1981

Dita e parë e Panairit të librit në Frankfurt, 14 tetor 1981

Saime Isufi: *"Hasan Mala, siç e kemi quajtur Plaku, me respekt të madh, ka qenë është dhe mbetet timonieri kryesor i Lëvizjes ilegale të mërgatës në Zvicër dhe më gjërë pas rënies së Kadri Zekës."* (Film dokumentar i Ismet Rashitit për Hasan Malën, nëntor 2012, minutat 01:15-01:32)

Ibrahim Kelmendi: *"Informim interesant nga Hasani fatkeq! Gjithë kohën edhe Hydajeti, edhe Kadriu e shfrytëzonin atë kryesisht si shofer. Nuk i jepnin mundësi të bëhej anëtar i OMLK-së, sepse kishin një stazh që duhej absolvuar, që do të thotë, duhej të dëshmohej si "kandidat" se është komunist i devotshëm. Ndërsa pas vrasjeve të kobshme edhe atij i erdhën tre ditë që të bluajë, si Nuhi Sulejmanit, Suzana Gërvallës, Xhafer Durmishit. Pra ai tashmë po përfaqësonte OMLK-në dhe ishte ai, Hasan mjeran, që ia dha "autorizimin" Xhafer Shatrit që t'ia bashkëngjis OMLK-në "bashkimit" të sajuar më 17 shkurt 1982, nga SN, Abdullah Prapashitica & Co."* (Gjurmë e fërkemë, libër i shpërnarë përmes internetit në shtator 2016)

Kur Hasan Mala i servon këto fjalë në janar 1997, Ibrahim Kelmendi ka qenë ulun përskaj tij. Pas 20 viteve njeriut të hazërxeveve i bien në mend se Hasani paska bërë informim fatkeq.

Në Panairin e librit në Frankfurt, të shtunën me 17 tetor, një ditë pas kthimit nga Stambolli, Jusufi ka rastin të takohet vetë me Kadri Zekën. Është shumë interesant thelbi i bisedës së tyre në Frankfurt, për të parë se "kujt i del punë me Jusufin e kujt jo?" Kadriu e din se Jusufi është informuar shumë saktësisht nga Bardhi se si kanë shkuar bisedimet në Stamboll dhe për atë çështje ai nuk lodhet me i përsëritë gjërat, dhe se pikërisht misioni i Bardhit në këtë rrugë ka qenë mision i dëshmitarit, që ky Besnik në aq mënyrë besnike i përshkruan. As Jusufi nuk humbë kohë me Kadriun për ta pyetur shumë se a janë të vërteta fjalët e Bardhit. Jusufi, sa

është i qartësuar dhe i kënaqur për qartësimin e shumë gjërave është edhe aq i revoltuar për shkakun se si është e mundur që Kadri Zeka, Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi dhe Berat Luzha t'ia japin vetes të drejtën për të vendosur, për ta etiketuar e klasifikuar Jusufin si individ, dhe si anëtarë i një Organizate, pra të vendosin ata dhe askush tjetër, as më shumë e as më pak se: a është Jusufi komunist apo nuk është?! Dhe jo vetëm kaq, por është shumë i revoltuar se si këta komunistë të paepur gjer në fund i kanë kërkuar ndihmë Jusufit (edhe pse jokomunist) për t'ua përgatitur 3 numra të *Lirisë* dhe për t'ua dërguar në Kosovë në ditët më kritike, dhe në të njëjtën kohë luftojnë me çdo kusht ta mbajnë në distancë të sigurt duke e etiketuar si jokomunist.

Thelbi i bisedës së Jusufit me Kadriun më 17 tetor 1981 në Frankfurt, të cilën Jusufi ma transmeton menjëherë pas mbarimit të saj është:

- Jusufi: Bardhi më tregoi se ti dhe shokët e tu e konsideroni LNÇKVSHJ-në si organizatë jokomuniste?
- Kadriu: Është e vërtetë se LNÇKVSHJ nuk është Organizatë komuniste.
- Jusufi: Se në LNÇKVSHJ ka mjaftë individë që nuk janë komunist, qoftë për shkak të bindjeve të formuara me kohë, qoftë për shkak se ende nuk kanë arritur të krijojnë botëkuptimet e tyre, këtë e pranoj.
- Kadriu: Nuk është fjala për individ, cili është e cili nuk është komunist, cili mund të jetë e cili mund të mos jetë komunist. Në LNÇKVSHJ asnjë anëtarë i vetëm nuk është komunist.
- Jusufi: Këto fjalë i thua ti duke më përfshi edhe mua. A vlejnë këto fjalë edhe për mua?
- Kadriu: Edhe për ty.
- Jusufi: Ta zëmë se nuk qenkam komunist në ditën e sotme. A mendon ti dhe shokët e tu se unë si individ kam gjasa që të bëhem komunist dhe të meritoj të quhem komunist ndonjëherë në të ardhmen?
- Kadriu: Pa u lodhur se si do të jetë e ardhmja dua të them atë që është kryesorja tani, se ti nuk je komunist!
- Jusufi: A mendon ti sipas kritereve tuaja, se të gjithë anëtarët e OMLK-së me të vërtetë janë komunist të formuar.
- Kadriu: Çdo anëtarë i OMLK-së është komunistë i formuar.
- Jusufi: Tani i kuptoj plotësisht Tezat e juaja dhe seriozitetin që meritojnë ato. Edhe pse njihemi personalisht që nga marsi, njohja në këto 3-4 ditët e fundit është shumë cilësore.
- Kadriu: Duke e parë relacionin tonë të deritanishëm në dritën e fakteve të reja konkrete që dolën nga rruga në Stamboll, a je i hidhëruar në mua dhe komunistët tanë që të jemi sjellë ndaj teje në atë mënyrë që ta do ta jepte të drejtën edhe ta quash shfrytëzim?
- Jusufi: Unë kam qenë tepër i vetëdijshëm se çka kam bërë dhe për këtë nuk pendohem por jam krenar me punën time, andaj në këtë pikë nuk ka pse me iu vra ndërgjegjja. Në politikë e në luftë, kush i shërben kujt, kush është pjesë e një plani më të përgjithshëm, kush është pjesëza e kush është e tëra, kush e shfrytëzon kend, kush del më i paepur deri në fund, se a do jem unë një figurë episodike në Frontin tuaj të madh, apo do të jeni ju figura episodike e të modës në Lëvizjen time, në planin e idealin tim të përjetshëm nuk dihet kurrë deri në finale, deri në fund.
- Kadriu: Duke e parë relacionin tonë në dritën e fakteve të reja a ke aq durim sa të pranosh të kesh kontakte me mua edhe në vazhdim dhe a ma çelë derën nëse ta mësyj?

- Jusufi: "Rrudhat mbi ballin tim, për mikun e vendlindjes, për aq sa kam pasur indikacione 34 vjet të jetës sime, kanë shprehur qartë pamundësinë për të fshehur ndjenjën e fuqishme të brengës për fatin e atdheut të robëruar; ato kanë treguar se janë **dyer kurdoherë të hapura kah shpirti, për të gjithë ata që kanë halle të ngjashme.**"
- Kadriu: Ne jemi bashkuar me Frontin e Kuq, pra me Ibrahim Kelmendin. Nuk kishte pas aq anëtarë, bile me të thënë të drejtën nuk ka pse të mbetet merak pse ti nuk je bashkuar me ta para nesh!
- Jusufi: Ia pafsh hajrin! Ditën e mirë!
- Kadriu: Ditën e mirë!

Jusuf Gërvalla: "Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj (e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z. [Kadri Zekën në panair, në Frankfurt, më 17 tetor - shën i Xh. D.]), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesha plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë, **as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z.**" (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 274)

Të shtunën më mbrëmje unë kthehem në Shtuttgart, ndërsa Jusufi qëndron në Frankfurt natën e së shtunës dhe të dielën.

Ismail Kadare: "Biseduam gjatë atë ditë midis rrëmujës së panairit dhe pastaj më gjatë në mbrëmje në një kafe të qytetit. Poet, prozator, publicist militant, Jusuf Gërvalla kishte të gjitha cilësitë dhe dimensionet që e bëjnë të shquar një personalitet të letrave e të kulturës. Për fat të keq mundësitë e tij mbetën të pashprehura plotësisht." (Jusuf Gërvalla, Rrotull, Tiranë 1983, faqe 3)

Në momentin e parë që më ra të takohem me Jusufin pas kthimit nga Frankfurti, u ngjitëm në katin e tretë ku ishte studioja e punës. Në tavolinën e tij të madhe dhe në fiokat e saj gjendeshin më shumë se 100 kopje të *Tezave* që i kishte radhitur, e të cilat nuk kishte arritë me i shpërnda dhe një tubë fletëpagesash për xhironlogarinë „*Hilfe für Kosova, Katharina Asal – Biel-Biene, Konto 25-45475, Biel-Biene Schweiz*". Ai i ndau 5-6 ekzemplarë të *Tezave* që t'i ruaj në arkivin e tij dhe kopjet tjera të *Tezave* së bashku me fletëpagesat, në praninë time i hodhi në shportën e mbeturinave. Me këtë veprim Jusufi ka dashtë të tregoj se Kështjella e Lëvizjes së tij është Kështjellë e lirë dhe e pamvarur në pikëpamje ideore, se në shtëpinë e tij askush pos tij nuk mund ta RUAJ rolin hegjemon, se Kështjella e tij është e lirë edhe në pikëpamje ekonomike pasi nuk ka kurrfarë obligimi t'i paguaj haraç ndokujt. Në të njëjtën kohë Jusufi kurrë nuk është përzier në punët e brendshme të të tjerëve e në shtëpitë e të tjerëve.

Kjo është e vërteta e trajtimit të *Tezave* të OMLK-së, nga ana e Jusufit, **para** takimit të Stambollit në mes Kadri Zekës e Sabri Novosellës, takim i cili u bë në praninë e dëshmitarit besnik Bardhosh Gërvalla. Kjo është e vërteta e trajtimit të këtyre *Tezave*, nga ana e Jusufit, **pas** takimit të Stambollit dhe jo vetëm kaq, por edhe **pas takimit** të Jusufit me Kadri Zekën, në Panairin e librit në Frankfurt më 17 tetor 1981.

27. As rastësisht nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur

Ibrahim Kelmendi: *"Pra, ose Jusufi vërtet nuk i ka kuptuar "tezat", ose paskësh qenë i kapur aq keq nga SN, sa të detyrohej që të katandiset në këtë farë nëniveli mjeran."* (Gjurmë e fërkemë, libër i shpërnarë përmes internetit në shtator 2016)

Mehmet Hajrizi: *"Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të **RUANTE ROLIN HEGJEMON.**"* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

Jusuf Gërvalla: *"Nga e gjithë kjo, tash mbeti vetëm dëshira. A ka vend të ndruhem si s'paska ardhur ende çasti i prituri i bashkimit? Ende po dua të shpresoj që qëndrimi i shokut Z. (Kadri Zeka - shën im) ndaj kësaj çështjeje të rëndësishme nuk është edhe qëndrimi i shokëve të tij, aq më pak vija e tyre dhe përfytyrimi i tyre për bashkimin.*

*Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj (e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z. [në panair, në Frankfurt, më 17 tetor - shën i Xh. D.]), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesh plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë, **as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të ÇORODITUR,** siç e kishte shtruar çështjen shoku Z. (Kadri Zeka - shën im)*

*Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës, por **MEGALOMANINË** e arrivistëve të revolucionit, **ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për DOMINIM ME ÇDO KUSHT MBI TË TJERËT.**"* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 274)

28. Janë si buka prej një brumi

Faktin se Lëvizja e Jusufit është quajtur Lëvizje Nacionalçlirimtare, Sabri Novosella është munduar ta shfrytëzoj në maksimum për ta paraqitur këtë Lëvizje si organizatë që nuk ka të bëjë asgjë me idetë komuniste.

Ibrahim Kelmendi: *"Po më vështirësohet formulimi i komentimeve, sepse secilën herë po trishtohem më shumë për shpërdorimin që ua ka bërë dhe po ua bën Sabri Novosella Jusufit, Xhaferit, Shefqetit, Metushit, etj."* (Gjurmë e fërkemë, libër i shpërnarë përmes internetit në shtator 2016)

Po më shtinë në gjynah Ibrahim Kelmendi, i cilësuar nga Jusuf Gërvalla si një nip i një agjenti me zile të UDB-së, me trishtimin e vetë. Unë e kam dëshmuar tërësisht se nuk kam avokaturën e tij.

Sabri Novosella: *"Porsi shteti amë, prapëseprapë njëra nga këto organizata bënte njëfarë dallimi. Kjo ishte LNÇKVSHJ, e cila udhëhiqej nga Metush Krasniqi, i cili ishte demokrat i vërtetë dhe mbi të gjitha ideologjinë komuniste e konsideronte si ideologji ruse dhe si të tillë edhe antishqiptare, ashtu siç i konsideronte antishqiptarë sllavogrekobizantinët në përgjithësi."* (Zëri, 28 mars - 4 prill 1992)

Kjo është taktika tepër e tejdukshme pas shembjes së 'komunizmit' dhe falimentimit të tij.

Faktin se Lëvizja e Jusufit është quajtur Lëvizje Nacionalçlirimtare e pamë se si është

shfrytëzuar maksimalisht dhe në mënyrë tejte të vendosur apo edhe të paepur gjer në fund, për ta parkuar atë në Frontin Popullor për Republikën e Kosovës dhe mbajtur në distancë të sigurt nga OMLK-ja, së bashku me elementët e dyshimtë, me krijesat e me Frontet e UDB-së, me arsyetimin se Lëvizja e Jusufit nuk është komuniste, se komunistët janë të ndërtuar prej një brumi të veçantë, se Jusuf Gërvalla nuk është prej brumit me të cilin është gatuar Mehmet Hajrizi, Hydajet Hyseni, Kadri Zeka e brat Berat Luzha. Pas falimentimit të *komunizmit të Mehmet Hajrizit dhe të shokëve të tij*, rishkrimi e falsifikimi i historisë nga këta të fundit bëhet me po aq taktika qesharake e të tejdukshme, krejtësisht identike me ato të Sabri Novosellës, sa me të vërtetë të hyn dyshimi se jo vetëm që janë të një brumi por mos janë edhe bineq të një nane, të larë e të shpërlarë në të njëjtën koritë.

Ibrahim Kelmendi: *"Konstatime interesante. Tamam ka vendosur pikën mbi i (edhe pse nuk ia di tamam domethënien e kësaj sintagme, "pikat mbi i"?)".* (Gjurmë e fërkemë, libër i shpërnarë përmes internetit në shtator 2016)

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. ...Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës."* (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, 31 korrik 1981)

Ja se si tingëllojnë ato në ditët e sotme:

Mehmet Hajrizi: *"Kjo Lëvizje (Lëvizje me 'L' të madhe si në Lëvizjen e Jusufit, ndërsa OMLK-ja si rezultat i Luftës së Yjeve as që përmendet - shën ynë), ndonëse në dukje e fragmentuar në kohë dhe hapësirë, ka njësinë e saj e lidhjet organike (nga i njëjti brum-shën ynë), prandaj duhet trajtuar e pandarë, pavarësisht fazave të zhvillimit dhe formave të veprimit nëpër këto faza. Aq më pak, ato mund t'i kundërvihen njëra tjetrës, siç provohet ndonjëherë për interesa meskine."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, f. 31)

Sabri Novosella: *"Dalja e shokut Xh. (Xhafer Shatri-shën im) e shkuarja tek shokët që para shumë vitesh i ka organizuar vet është bërë shumë mirë, bile më mirë se sa të kishte ardhë tek ju, pasi në atë organizatë motër Xh. gëzon besim shumë të madh, kurse nga ana tjetër me një shok që e kemi këtu ka afërsi shumë të madhe qysh nga koha e vuajtjes së dënimeve në kazamatet jugosllave para 13 viteve. Përveç kësaj ekziston edhe një histori tjetër që i lidhë këta dy shokë për lirinë e popullit tonë. Pasi edhe deri më tani është punuar në bashkimin e organizatave tona, nga ana tjetër nuk ekzistojnë kurrfarë divergjencash parimore, mund të themi se çështja e bashkimit mund të merret si punë e kryer."* (Letër 'Komitetit Vëllezërit Gërvalla' në Shtutgart, mars 1982)

Ta dëgjojmë se sa është në gjendje ta pranoj Mehmet Hajriz-Strofcin në *Strofullin* e Lëvizjes së Jusufit askush tjetër pos

Shefqet Jashari-Strofcin: *"Ta zëmë rastin kur është futur në kryesinë e ngushtë Jusuf Gërvalla. Unë nuk kam ditur si quhet, çfarë profesioni ka, ku punon dhe jeton dhe ku ka lindur. Sabriu ka thënë se e njoh një kohë të gjatë, është atdhetarë i mirëfilltë, d.m.th. i painfektuar nga ideologjia e djallit të mallkuar bolshevik."* (Drita, Trelleborg, Suedi, nr. 15, 1997, f. 15)

Unë mendoj se të paktën Shefqet Jashar-Strofcin duhet ta lëmë të qetë duke shpresuar që të paktën në atë dynja nuk do të përsërit akuzat kundër djajve të mallkuar bolshevik, apo ndoshta në rastin më fatlum qysh gjatë kësaj dynjaje të rrejshme do t'ua jep hallallin.

Sikur të ishte gjallë Jusufi me siguri kundër Shefqet Jashar-Strofcit dhe luftës së tij për ta ruajtur të pastër Strofullin e Lëvizjes së tij, do t'i përdorte vargjet:

"O bilbil ta bëra benë, në ta gjetsha dot folenë..."

Se sa organike e të pandara kanë qenë lidhjet e Lëvizjes së Jusufit me OMLK-në e komunistëve për meritën e komunistëve na duket shumë qartë. Për këtë do të kemi edhe disa letra të shkruara nga Jusufi që do t'i ndeshim në raste tjera. Sa lodhemi t'i shqyrtojmë "*Lidhjet e pandara organike të Lëvizjes së Jusufit me OMLK-në*" a nuk do të ishte shumë më mirë t'i shohim pak se sa të pandara e sa organike janë lidhjet e komunistëve të paepur të vitit 2008 me të kaluarën e tyre të vitit 1981.

Se çka kanë menduar në vitin 1981 Mehmet Hajrizi, Hydajet Hyseni, Berat brati e Kadri Zeka e kemi pa në Tezat rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Ja si manifestohen lidhjet organike me këto Teza, mendimet e autorëve të tyre në vitin 2008.

29. Iu kemi kundërvu ideologjisë komuniste

"Apostol Duka: Thatë se e ndërruat emrin e Grupit tuaj Revolucionar. Më lejoni t'ju pyes: E ndërruat sepse bindjet tuaja ideologjike ishin marksiste-leniniste, e ndërruat sepse duhej ndërruar, apo e bëtë këtë gjë për të qenë të ngjashëm me veprimtarinë politike e ideologjike të shtetit-amë?"

Mehmet Hajrizi: *E kuptoj këtë pyetje me ngut. Sot, pas kaq vitesh, duhen sqaruar këto emërtime të Organizatës, që për brezin aktual duken demode dhe të largëta, edhe pse nuk e cënojnë aspak karakterin nacionalçlirimtar dhe rëndësinë historike të saj...*

Lëvizja Kombëtare e Kosovës, ideologjinë marksiste që ishte në modë atëherë, e ka përdorur si kulturë dhe mjet për çlirim." (Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, f.163-164)

Mehmet Hajrizi: *"Ndikimi nuk mund të mohohet, por ne fokusoheshim tek shkelja nga udhëheqja jugosllave e parimit të vetëvendosjes së popujve, e cila ishte pjesë përbërëse e doktrinës leniniste dhe premtim demagogjik i Titos e partisë së tij komuniste." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f.165)*

"Së katërti regjimi socialist pushtues po luftohej me socializëm edhe për një arsye që e diktonin rrethanat historike." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, f.166)

Mehmet Hajrizi: *"Sot, tridhjetë e pesë vjet pas, duhet sqaruar shkurtimisht këto emërtime të Organizatës, që për brezin aktual nuk janë të afërta as të pranueshme." (Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, f. 96)*

Mehmet Hajrizi: *"Sabile Keçmezi-Basha ka shkruar; "Organizata e cila pati më së tepërmi jehonë në qarqet e përgjithshme të popullatës shqiptare dhe e cila kontribuoi që rrjedhat e shoqërisë ish-socialiste në Kosovë të merrnin kah krejt tjetër, ishte pasardhësja e 'Grupit Revolucionar' që më vonë u shndërrua në Organizatën ilegale shqiptare "Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës." (Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, f. 316)*

Brat Berat Luzha: *"Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*

'Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 220)

Brat Berat Luzha: "Përmes ngjyrimin ideologjik, kemi tentuar t'i kundërvihemi ideologjisë komuniste titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 220)

Brat Berat Luzha: - Lidhjet me Shqipërinë kujtoj ishin mjaft të brishta, kryesisht përmes ambasadave të saj. Unë nuk kam qenë protagonist i këtyre lidhjeve, prandaj nuk mund ta di saktë këtë gjë. Kadri Zeka ka vepruar në Zvicër dhe ai ka pasur disa kontakte me ambasadën shqiptare në Vjenë. Ndonjë takim mund të kenë bërë edhe kuadro të tjerë të organizatës, por asnjëherë për çështje ideologjike." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 223)

"A. Duka: -A ishte organizata e Jusufit marksiste-leniniste?"

Brat Berat Luzha: - Ashtu nuk e quante veten, por kishte platformë të ngjashme me organizatën tonë dhe me organizatat e grupet tjera ilegale." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 224-225)

30. Patentimi i formulës sekrete të lirisë dhe përralla e Crvenkapës

Më lartë e kemi pa luftën e Mehmet Hajrizit, Kadri Zekës dhe shokëve të tyre për ta mbajtur OMLK-në të pastër dhe në distancë të sigurt nga Jusufi dhe Lëvizja e tij, në vitin 1981 e 1982. Sabri Novosella dhe Jusufi nuk e pranojnë tutelën e Mehmet Hajrizit dhe Kadri Zekës të cilët e parashtrajnë situatën në mënyrë raciste duke thënë se vetëm ata kanë monopol në idetë komuniste, thuase ata e kanë zbuluar atë ide. Ja se çka shkruan Jusufi për shtegtimin e ideve komuniste dhe qëndrimin e Shqipërisë zyrtare në atë kohë:

Jusuf Gërvalla: "Mbi idetë dhe lëvizjet përparimtare asnjë popull nuk mund të vërë dorë përgjithmonë, ashtu si e vë **njeriu kësulën (Crvenkapën - shën i Xh. D.) në kokën** e vetë të patjetërsueshme. Ku zënë fill, nga shtegtojnë dhe ku ngrehin çerdhe lejlekët e anës së ndriçuar të vetëdijes së Planetit, është punë që nuk mund të hetohet jashtë ligjshmërisë dialektike, dhe kjo ligjshmëri për të paditurin shfaqet përplot pusi.

Ideja e madhe komuniste mori krah në Gjermani, me Marks në ballë. U avancua dhe materializua në Revolucionin e madh rus, të cilit i priu Lenini...Por pasi braktisi stepet e paskajshme, e pezmatuar në tradhtinë e akullt hrushoviane, **ideja** e madhe komuniste u strehua dhe nguliti në Shqipërinë e 'vogël'. Këtu gjeti prehje dhe truall të përshtatshëm për lulëzim të plotë. Së këndejmi fshikullon sot pa mëshirë imperializmin dhe social-imperializmin, 'eurokomunizmin' fodull. Këtu u bë fener për proletarin, të nënshtruarin, të kolonizuarin. Kudo në botë. Sepse siç thotë poeti, **Shqipëria është një magje lirish, që formulën e lirisë nuk e mban sekret.**" (Lajmëtari i lirisë, tetor-nëntor 1980, faqe 4.)

Tek disa popuj thuhet se gëzimi i ndarë me dikend dyfishohet ndërsa dhimbja e ndarë me dikend përgjysmohet. Me sa duket kjo vlen më shumë në teori se sa në praktikë aq më pak në politikë. Shumë më reale duken thënie: Nëse del një punë mirë, atë e bëra unë dhe rezultati më takon vetëm mua. Nëse del keq atëherë atë e bëtë ju dhe pasojat duhet të bien vetëm mbi ju. Në rastin më të mirë e më ekstrem sa i përket pjesës së dytë, thuhet edhe forma: nëse del keq pasojat na takojnë të gjithëve në mënyrë solidare. Në zanatin e ndyrë të politikës këto djallëzi e kopili është vështirë me i pa tërë kohën. Në fushën e ekonomisë këto çështje janë aq të ndara e të pastra sa nuk ka ku shkon më tej dhe duken si drita e diellit dhe janë çështje që rregullohen me ligje të tëra.



Mjerisht, Cërvenkapa dhe Gjyshja i kanë disa mosmarrëveshje jo vetëm konceptuale por edhe triviale

Themelimi, starti i një ndërmarrje ekonomike nuk është gjithmonë vetëm premtues e i lidhur me prurjen e fitimeve por në vete përmban edhe rrezikun që kapitali i investuar të humbas. Në këtë pikë që në fillim partnerët, palët merren vesh për ndarjen e rrezikimeve për të cilat janë të vetëdijshëm që në fillim. Përveç rrezikut të humbjes si pasojë e natyrës së ekonomisë, ekzistojnë fatkeqësitë të shkaktuara qoftë nga faktori njeri qoftë nga natyra. Edhe për këso lloj rreziqesh me kohë paguhet e lidhen kontrata që kanë të bëjnë me fushën e sigurimeve. Këto gjëra në fushën e ekonomisë janë të qarta dhe shumë të definuara, të cilat në mënyrë të përafërt ndoshta mund të thuhet se i përmbledh fjalë e përgjithshme, nëse del keq, e keqja le të shpërndahet në sa më shumë veta, dhe mundësisht askush të mos merr përgjegjësi personale.

Rasti i kundërt është ai kur një ide complete e mirë, një formulë kimike, apo një kombinim formulash kimike që e përbëjnë një ilaç të mirë, patentohet nga firma, në mënyrë që vetëm ajo të ketë të drejtë ta shes atë ilaç për 10 vjet, apo për një kohë të caktuar në mënyrë që t'i mbuloj shpenzimet e investimeve dhe shpenzimet tjera, plus të nxjerrë njëfarë fitimi. Në ekonominë e vendeve më të zhvilluara kështu veprohet dhe askush nuk çuditet pse është kështu. Nëse një profesor i një universiteti serioz merret me vjedhje e plagjiaturë ai përjashtohet nga puna dhe i

duhet të zgjedhë ndonjë profesion ku hajnia sjellë fitime më të mëdha.

Në vitin 1981 e 1982, Mehmet Hajrizi, Kadri Zeka dhe shokët e tyre nuk e kanë njohur asnjë veprimtari të tjerëve si aktivitet e lere më për të barabartë, dhe hisen e komunizmit të tyre nuk kanë dashtë me e nda me askënd. Kur ky komunizëm i tyre, QË E RUAN ROLIN HEGJEMON, ka falimentuar, këta dezertojnë nga postet e tyre (megjithëse janë të paepur gjer në fund) dhe mundohen me na e mbush mendjen se të gjitha organizatat e asaj kohe kanë qenë të ngjashme, identike me lidhje organike e të pandara, dhe se interesat meskine nuk mund t'i hedhin kundër njëra tjetrës.

Ja se si u bien mistri ish-ministri i propagandës Xhafer Shatri, dështimit të bisedimeve të Stambollit në mes OMLK-së dhe LNÇKVSHJ-së.

Xhafer Shatri: *"Një takim i mbajtur në Stamboll, në tetor të vitit 1981, e në të cilin kishin marrë pjesë në një anë, Kadri Zeka si përfaqësues i OMLK-së, dhe në anën tjetër Sabri Novosella e Bardhosh Gërvalla, si përfaqësues të LNÇKVSHJ-së kishte dështuar jo vetëm për shkak të dallimeve konceptuale."* (20 vjet nga vrasja e Vëllezërve Gërvalla dhe e Kadri Zekës, www.pashtriku.org)

Mehmet Hajrizi si ideolog i vërtetë që i kupton gjërat në tërë kompleksitetin e tyre na e heq tërë mjegullën para syve dhe e zbërthen edhe më tej mendimin e shokut të vet.

Mehmet Hajrizi: *"Në tetor të vitit 1981 Një takim i mbajtur në Stamboll, midis Kadri Zekës si përfaqësues i OMLK-së e i Tezave të Frontit, dhe të Sabri Novosellës e Bardhosh Gërvallës, si përfaqësues të LNÇKVSHJ-së kishte dështuar bashkimi i organizatave për shkak të dallimeve konceptuale, por edhe për arsye tjera triviale."* (Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, f. 292)

Saime Isufi: *"Më 18 tetor të vitit 1981, u nisa përsëri për në Zvicër. Kadriu nuk ndodhej në Zvicër. Ai kishte qenë në panairin e librit në Frankfurt dhe **pastaj** kishte udhëtuar me Bardhosh Gërvallën në Turqi, për bisedime rreth bashkimit të organizatave me udhëheqësin e LNÇKVSHJ, Sabri Novosellën. Në banesën e tij na priti Hasan Malaj, mua dhe Berat Luzhën. Me Hasanin, që atë natë udhëtua dikur në Gjermani për të marrë Kadriun. U takuam me Kadriun. Dukej shumë i lodhur, i rraskapitur, por edhe i dëshpëruar nga takimi që kishte pasur me Sabri Novosellën.*

Ai nuk i kishte përfillur, bile i kishte fyer e poshtëruar atë dhe Bardhosh Gërvallën." (Apostol Duka, Vrasje në Shtuttgart, f.98)

Sabri Novosella: *"Sa i përket asaj se unë paskam folur keq për Zeqën, kjo ka qenë kështu: Më pyeti Uka (Xhafer Shatri-shën. i Xh. D.) se pse janë prishë Jusufi me Zeqën kohëve të fundit? Ju përgjigja ashtu si ka qenë. Pas bisedimeve në Stamboll, Zeqa (Kadri Zeka-shën i Xh. D.) ia kishte dërguar një vendim të rrejshëm se gjoja ishte formuar "Fronti për Republikën e Kosovës", gjë që Sokoli (Jusuf Gërvalla-shën i Xh. D.) ishte hidhëruar së tepërmi dhe i kishte thanun në një letër: Çdo gjë që e ka fillimin në gënjeshtër është e gjykuar në dështim që në fillim. Në lidhje me bisedimet e Stambollit ia pata dërguar një letër të Sokolit Ukës e cila ia kishte luajtur mendjen dhe tash po mundohet me qipfë diçka kundër meje në atë drejtim, por atë letër po ua dërgoj edhe juve."* (Letër Faridin Tafallarit e Xhafer Durmishit, 16 janar 1984)

Në këtë rast nuk e shoh të rrugës as nuk e kam për detyrë t'u tregoj të tjerëve se ku ka qenë Kadri Zeka në këtë kohë, por për shkak se përmendet Bardhoshi e kam detyrë ta përsëris edhe njëherë, kur është hapur Panairi i librit të mërkurën më 14 tetor 1981, Bardhoshi e Kadriu kanë qenë në Turqi, dhe prej atje janë kthyer të premtën më 16 tetor. Të shtunën më 17 tetor 1981, në lokalet e panairit Kadriu i ka tregua Jusufit se ai apo OMLK-ja është bashkuar me Frontin e Kuq e me Ibrahim Kelmendin. S. Isufi paska ardhë në Zvicër me Berat Luzhën të dielën më 18 tetor. Nëse Kadriu nuk është kthyer shpejtë në Zvicër, shkaku për këtë janë punët që i kanë dalë nga bashkimi me Ibrahim Kelmendin dhe jo kohë e kaluar me Jusufin apo me Bardhoshin në ndonjë rrugë në Turqi.

Bardhi (edhe pse i 'fyer e i poshtëruar') kishte sjellë nga Turqia selamin e Sabriut që të fillohet me nxjerrjen e "Zërit të Kosovës", si organ i LNÇKVSHJ-së, me arsyetimin se boll kemi ba sabër. Puna në nxjerrjen e "Zërit të Kosovës" që e shpejtë pasi artikujt për numrin e parë ishin pothuajse të gjithë të gatshëm qysh nga mesi i gushtit. Numri i parë doli në fillim të nëntorit 1981.

Mehmet Hajrizi: "Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të **RUANTE ROLIN HEGJEMON.**" (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

Jusuf Gërvalla: "Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj (e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z. [në panair, në Frankfurt, më 17 tetor - shën i Xh. D.]), ishte e vetëkuptueshme të **pajtohesha plotësisht** me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë, **as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur**, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z (Kadri Zeka - shën im).

Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës, por **MEGALOMANINË** e arrivistëve të revolucionit, **ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për DOMINIM ME ÇDO KUSHT MBI TË TJERËT.**" (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 274)